



USHTRIA



Viti i 77-të i botimit Nr. 41 (827896)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 18 tetor 2024

Ministri i Mbrojtjes Vengu: Shqipëria, e palëkundur në mbështetjen e saj ndaj Ukrainës



Meetings of NATO Ministers of Defence

17-18 X 2024

Réunions des ministres de la défense

Miratohet Projekt - Vendimi për trajtimin e ushtarakëve me pagë dhe shtesa mbi pagë për kushte të veçanta shërbimi

Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit të Mbrojtjes, miratoi vendimin që përmirëson trajtimin financiar për personelin ushtarak që shërben në strukturat e Forcave të Armatosura. Ky projekt-vendim realizoi synimin parësor për një rritje gjithëpërfshirëse të trajtimit me pagë të personelit ushtarak aktiv të Forcave të Armatosura, në kuadër të vijimit të reformës së rritjes së pagave të nëpunësve/punonjësve të administratës publike, të ndërmarrë nga qeveria shqiptare.

Pjesë e kësaj pakete ligjore janë dhe përmirësime të tjera që konsistojnë në rritjen e pagës për titull akademik/gradë shkencore/kualifikim shkencor për ushtarakët e Akademisë së Forcave të Armatosura; ndryshimin e masës së shtesës për kushte të veçanta shërbimi për ushtarakët e personelit fluturues dhe mbështetës të fluturimeve, të ushtarakëve të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe ushtarakëve të tjerë të shërbimit aktiv, duke synuar përafrimin e sistemit të pagave me strukturat e tjera të sigurisë në vend, dhe një përjasje sa më të mirë me përvojat e vendeve të NATO-s. Kjo shtesë mbi pagë, është vijimësi e rritjes prej 30% në vitin 2022 dhe 7% në vitin 2024, që kishte për qëllim një trajtim sa më dinjitoz për të gjithë personelin ushtarak aktiv në Forcat e Armatosura.

Miratimi i këtij vendimi, implementimi i skemës së qeverisë për dhënie të kredisë për banesë me 0% interes dhe një sërë përfitimesh tjera që rrjedhin nga statusi i ushtarakut, janë dëshmi e mbështetjes për punën e palodhur dhe përkushtimin e jashtëzakonshëm të personelit të Forcave të Armatosura. Përveç motivimit dhe rritjes së mirëqenies së personelit ushtarak, kjo paketë përfitimesh pritet të japë efekte pozitive në proceset e rekrutimit dhe mbajtjes së personelit në strukturat e Forcave të Armatosura.

Në kuadër të rristurimit të FA-së, një tjetër hap i rëndësishëm ka qenë rishikimi dhe miratimi i dokumenteve strategjike dhe akteve që rregullojnë veprimtarinë e FA-së, si: Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë, e harmonizuar me Strategjinë Ushtarake të NATO-s dhe Planin Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave të Armatosura, dokumente këto të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë në muajin korrik të këtij viti.

Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga këto dokumente strategjike ka vijuar procesi i planifikimit dhe hartimit të planeve kombëtare të mbrojtjes, në harmoni me planin rajonal të Aleancës, në linjë me Konceptin e Ri Strategjik të NATO 2022, modelin e ri të forcës, dhe realitetin e ri të sigurisë.

Krahas implementimit të strukturës së re



organizative të FA-së, po punohet për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.194/2015 në interes të harmonizimit të emërtimeve të funksioneve organike në strukturat e prekura nga implementimi i kësaj strukture.

Po kështu, është rishikuar ligji 59/2014 "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", ku ndryshimi

konsiston në rritjen e moshës së pranimit dhe shërbimit, ndarja e komisioneve të karrierës në forcat kryesore, sipas nivelit të gradave, dhe një sërë rregulloresh që kanë si fokus përmirësimin e funksionimit të aktivitetit në Forcat e Armatosura.

Aktualisht, po punohet për harmonizimin e akteve ligjore dhe nënligjore për përmirësimin

e komandim-kontrollit, politikave të rekrutimit dhe mbajtjes së personelit; statusin e ushtarakut të FARSH-së; ligjin e disiplinës, si dhe ligjin e organizimit të shërbimit ushtarak rezervist.

Këto përmirësime ligjore do të garantojnë zhvillimin e mëtejshëm dhe afatgjatë të Forcave të Armatosura, në përmbushje të detyrimeve kombëtare dhe detyrimeve ndaj Aleancës.

Ministri i Mbrojtjes: Pasurimi i flotës së mjeteve në Forcën Tokësore, hap tjetër drejt modernizimit

Forcat e Armatosura tashmë janë pajisur me autoblanda amerikane. Mjete taktike të blinduara për efektivitet e Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë (BKL), i janë shtuar prej pak ditësh flotës së Forcës Tokësore të ushtrisë shqiptare, duke rritur ndjeshëm kapacitetet e saj operacionale.

Forca Tokësore, tashmë me hapa të sigurt drejt standardeve që kërkon Aleanca e Atlantikut të Veriut për anëtarët e saj, pas rritjes së buxhetit për shpenzimet ushtarake në 2% të PBB-së.

Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu, për këtë arritje të radhës të Forcave të Armatosura u shpreh se: "falë asistencës së aleatit strategjik, SHBA-së, tashmë Forca Tokësore hedh një hap tjetër drejt modernizimit, një proces që do të vijojë edhe me rritjen e industrisë ushtarake, duke rikthyer prodhimin e armëve në uzinën e Poliçanit, Gramshit dhe Mjekësit. "Ky investim shënon një hap të rëndësishëm në procesin e modernizimit dhe rritjes së gatishmërisë së strukturave ushtarake, në përputhje me prioritetin tonë për forcimin e infrastrukturës mbrojtëse. Pasurimi i flotës së mjeteve në Forcën Tokësore është gjithashtu një element për rritjen e aftësive tona mbrojtëse dhe përmbushjen e standardeve ndërkombëtare".





Ministri Vengu: Shqipëria, e palëkundur në mbështetjen e saj ndaj Ukrainës

Ministri i Mbrojtjes Piro Vengu mori pjesë në Samitin dyditor të Ministrave të Mbrojtjes së vendeve të NATO-s, në Bruksel.

Ky Ministerial drejtohet për herë të parë nga sekretari i ri i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte.

Në qendër të diskutimeve të Ministrave të Mbrojtjes ishte strategjia për të vepruar më shpejt dhe më efektivisht, me theks të veçantë në investimet në kapacitete dhe teknologji të reja.

Fokusi i këtij ministeriali ishte lufta në Ukrainë, planet e ardhshme të mbrojtjes të aleancës dhe prodhimin e industrisë së mbrojtjes.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte kryesoi takimin e ministrave të Mbrojtjes për herë të parë pas marrjes së detyrës. Të pranishëm ishin presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky dhe ministri i Mbrojtjes Rustem Umerov.

Aleanca ushtarake perëndimore u mbledh në selinë e NATO-s, pasi presidenti ukrainas Volodimir Zelensky zbuloi një "plan fitoreje" të shumëpritur për t'i dhënë fund luftës me Rusinë.

Sekretari amerikan i Mbrojtjes, z. Lloyd Austin përshëndeti dhe vlerësoi angazhimin serioz të vendeve aleate dhe partnere në Koalicionin për mposhtjen e ISIS, i cili mbetet një prej koalicioneve me pjesëmarrjen më të gjerë dhe me rezultatin më inkurajues në terren. Pjesëmarrësit në këtë takim, të konceptuar si një mini samit përpara zhvillimit të Ministerialit të Mbrojtjes së NATO-s, u njohën me hapat konkretë, që do të ndërmerren në fazën e tërheqjes së pjeshme të trupave amerikane nga Iraku si edhe me planet e Aleancës për të vijuar me trajnimet, këshillimin dhe asistencën ndaj institucioneve të Irakut nëpër-



mjet misionit NMI.

Gjatë punimeve të ditës së parë të ministerialit, fokusi kryesor ishte lufta në Ukrainë dhe vijimi i mbështetjes nga Aleanca për zbatimin e vendimeve të Samitit të Uashingtonit. Këto çështje u trajtuan në detaje gjatë takimit të Këshillit NATO - Ukrainë, ku morën pjesë vende aleate dhe partnere të NATO-s, si dhe ministri i Mbrojtjes së Ukrainës, z. Rustem Umerov, i cili përditësoi mbi situatën e luftimeve në terren dhe paraqiti kërkesat e Ukrainës për mbështetje të mëtijshme, kryesisht në prag të sezonit të dimrit.

Në këtë kontekst, u theksua nevoja imediate për mbështetje ushtarake për Ukrainën, veçanërisht në mbrojtjen ajrore dhe municione, me qëllim mbrojtjen e infrastrukturës kritike nga agresioni rus. Vendet aleate shprehën një qëndrim të unifikuar për vazhdimin e kontributeve dhe ruajtjen e solidaritetit dhe kohezionit në mbështetje të popullit ukrainas dhe luftës së tij, si dhe për mbështetje të palëkundur në rrugëtimin e Ukrainës drejt integritetit euroatlantik. Në këtë takim, ministri i Mbrojtjes, z. Piro Vengu, rikonfirmoi angazhimin e vendit tonë, krah vendeve aleate në mbështetje të palëkundur për Ukrainën në përpjekjet e saj për stabilitet dhe siguri. Ministri Vengu njoftoi se së shpejti do negociohet mes dy vendeve për të lidhur "Marrëveshjen mbi bashkëpunimin për sigurinë dhe mbështetjen afatgjatë ndërmjet Shqipërisë dhe Ukrainës". Ai deklaroi gjithashtu, se Shqipëria do të angazhohet për të ofruar trajnim për personelin ushtarak të Ukrainës.



Gjeneralmajor Arben Kingji merr pjesë në Konferencën e 12-të të Iniciativës së Bashkëpunimit në Fushën e Mbrojtjes (DECI)

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji, mori pjesë në Konferencën e 12-të të Iniciativës së Bashkëpunimit në Fushën e Mbrojtjes (DECI), e cila u zhvillua në Vjenë, Austri. Kjo iniciativë kryesohet nga Italia dhe ka në përbërje të saj Shqipërinë, Austrinë, Hungarinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut. Përveç përfaqësuesve të vendeve anëtare, në nivel Shef Shtabi, në konferencë morën pjesë edhe zëvendëskomandanti i Forcës së Bashkuar të NATO-s në Itali, gjenerallejtënant Peter Scott, zëvendëskomandanti i KFOR, gjeneral brigade Federico Bernacca, komandanti i EUFOR, gjeneralmajor Laszlo Sticz, si dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Bosnje-Hercegovinës, gjeneralmajor Gojko Knezevic. Çështjet kryesore të zhvilluara gjatë këtij takimi përfshijnë stabilitetin dhe sigurinë rajonale; zhvillimin e kapaciteteve, trajnimeve dhe mundësive për bashkëpunim si dhe përfshirja e DECI në organizata ndërkombëtare. Në seancën e parë u ofrua një përditësim mbi situatën e sigurisë nga zëvendëskomandanti i Komandës së Forcës së Bashkuar të NATO-s në Napoli, zëvendëskomandanti i KFOR-it dhe nga komandanti i EUFOR, për të vijuar më tej me diskutimet dhe shkëmbimin e mendimeve të Shefave të Shtabit. Në fjalën e tij në këtë seancë, SHSHPFA gjeneralmajor Arben Kingji, pasi falënderoi homologun austriak për organizimin e konferencës, vuri theksin në rolin e bashkëpunimit ushtarak për një mjedis të qetë dhe të sigurt.

Gjeneralmajor Arben Kingji vlerësoi se sfidat dhe dinamikat në mjedisin e sigurisë shtrojnë nevojën për nxitjen e bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Më tej, gjatë fjalës së tij ai u ndal gjithashtu edhe në rolin e vendit tonë për nxitjen e bashkëpunimit dhe stabilitetit rajonal, përpjekje këto të çuara edhe më përpara gjatë kryesimit nga vendi ynë përgjatë gjithë këtij viti, i iniciativave rajonale të shefave të shtabit të Ballkanit dhe SHBA-Karta e Adriatikut. Ai vlerësoi situatën në Veri të Kosovës si delikate dhe dënoi çdo tentativë për të destabilizuar situatën dhe cenuar integritetin territorial të Kosovës. Në seancën e dytë dedikuar zhvillimit të kapaciteteve, trajnimeve dhe mundësive për bashkëpunim, u diskutua rreth projekteve dhe angazhimeve të përbashkëta me qëllim nxitjen e bashkëpunimit dhe ndërveprueshmërisë. Në këtë seancë, gjatë fjalës së tij, gjeneralmajor Arben Kingji vlerësoi rolin proaktiv të Italisë si vend



GJENERALMAJOR ARBEN KINGJI VLERËSOI SE SFIDAT DHE DINAMIKAT NË MJEDISIN E SIGURISË SHTROJNË NEVOJËN PËR NXITJEN E BASHKËPUNIMIT NË FUSHËN E SIGURISË DHE MBROJTJES. MË TEJ, GJATË FJALËS SË TIJ AI U NDAL GJITHASHTU EDHE NË ROLIN E VENDIT TONË PËR NXITJEN E BASHKËPUNIMIT DHE STABILITETIT RAJONAL, PËRPPJEKJE KËTO TË ÇUARA EDHE MË PËRPARA GJATË KRYESIMIT NGA VENDI YNË PËRGJATË GJITHË KËTIJ VITI, I INICIATIVAVE RAJONALE TË SHEFAVE TË SHTABIT TË BALLKANIT DHE SHBA-KARTA E ADRIATIKUT. AI VLERËSOI SITUATËN NË VERI TË KOSOVËS SI DELIKATE DHE DËNOI ÇDO TENTATIVË PËR TË DESTABILIZUAR SITUATËN DHE CENUAR INTEGRITETIN TERRITORIAL TË KOSOVËS.

kryesues i kësaj iniciative, si dhe përmendi disa nga angazhimet e FARSH-së në struktura shumëkombëshe, rritjen e kontributit në KFOR dhe vullnetin për të rritur prezencën në krahun lindor të NATO-s dhe në EUFOR.

Në fjalën e tij, ai theksoi integritimin euroatlantik

të vendeve aspirantë dhe prezencën e NATO-s dhe BE-së, si elemente kyç për stabilitetin dhe sigurinë e rajonit. Në seancën e tretë u diskutua rreth bashkëpunimit aktual të DECI me organizatat ndërkombëtare dhe mendësitë e nxitjes së këtij bashkëpunimi në të ardhmen. Duke marrë në konsideratë rëndësinë

e bashkëpunimit rajonal, gjeneralmajor Arben Kingji vlerësoi dhe shprehu mbështetjen për nismat që mund të kontribuojnë në këtë drejtim, si dhe vuri theksin në nevojën për të mbështetur mundësitë e arsimit dhe stërvitjes, duke marrë në konsideratë rolin e tyre në zhvillimin dhe ndërveprueshmërisë së personelit.





U zhvillua konferenca “BalkanSecure 2.0”

Një hap përpara në sigurinë kibernetike!

Konferenca “BalkanSecure 2.0” në Shqipëri, një ngjarje e rëndësishme që ka si qëllim përmirësimin e kapaciteteve të reagimit ndaj incidenteve kibernetike në Ballkanin Perëndimor.

Kjo konferencë dyditore bashkon profesionistë nga i gjithë rajoni, përfaqësues të CERT/CSIRTs, dhe ekspertë të fushës për të ndarë praktikë më të mira dhe për të forcuar bashkëpunimin ndërkufitar. Në një kohë kur kërcënimet kibernetike po rriten në kompleksitet dhe shkallëzim, zëvendësministri i Mbrojtjes Dorian Tola theksoi se më e rëndësishme se kurrë është që të jemi të koordinuar dhe të përgatitur. “BalkanSecure 2.0” synon të krijojë një komunitet të fortë dhe të bashkuar për të përballuar sfidat e sigurisë kibernetike. Falë mbështetjes së “Sense Cyber Research Center, Chevening Alumni Kosovo” dhe FCDO të Mbretërisë së Bashkuar ky bashkëpunim ofron mundësinë për një Ballkan Perëndimor më të sigurt!



Kontingjenti VI i Forcës Detare niset në misionin e NATO-s në detin Egje

Në Komandën e Forcës Detare u zhvillua ceremonia e përcjelljes së Kontingjentit VI të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për misionin e NATO-s në detin Egje.

Kontingjenti u përshëndet nga zëvendësministri i Mbrojtjes Dorian Tola, i cili vlerësoi kontributin e tyre në parandalimin e emigracionit të paligjshëm dhe mbrojtjen e jetëve njerëzore, duke theksuar angazhimin e tyre për një mjedis më të sigurt dhe human.

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, vlerësoi profesionalizmin e efektivëve dhe theksoi se Forca Detare po transformohet për të përmirësuar operacionet dhe ndërveprueshmërinë me vendet partnere të Aleancës. Ai uroi kontingjentin për suksese në shërbimin ndaj atdheut dhe NATO-s.



Grupi i rikonicionit Joint Logistic Support Group - NATO Rapid Deployable Corps Italy, realizoi një vizitë njohëse në KM



Grupi i rikonicionit “Joint Logistic Support Group” - Nato Rapid Deployable Corps Itali (JLSG-NRDC-ITA) zhvilloi një vizitë njohëse në mjediset e Komandës Mbështetëse, në kuadër të detyrimeve për vënien në dispozicion të infrastrukturës kombëtare në funksion të Rrjetit të Përforsimit dhe Mbështetjes (RSN) gjatë zhvillimit të operacioneve të ndryshme në rolin e host nation.

Grupi i rikonicionit, i kryesuar nga gjeneral brigade Efsthios Kokkinidis, u prit në takim nga zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela.

Nëpërmjet një brifingu prezantues grupi i rikonicionit u njoh ndër të tjera me kapacitetet mbështetëse, magazinuese, transportuese dhe të mirëmbajtjes që disponon Komanda Mbështetëse.



Takimi i Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s: Fokus Ukraina dhe Indo-Paqësori

Ministrat e Mbrojtjes të NATO-s u mbledhën në Bruksel në takimin dy-ditor të radhës, për të diskutuar mbrojtjen dhe parandalimin, mbështetjen për Ukrainën dhe partneritetet globale.

Në ditën e parë të takimit, ministrat e Mbrojtjes të NATO-s ranë dakord për të rritur bashkëpunimin me partnerët e tyre të Indo-Paqësorit dhe për të rritur mbështetjen për Ukrainën.

Në sesionin e parë të takimit dyditor, Ministrat e Mbrojtjes u takuan në një format të zgjeruar që për herë të parë përfshinte partnerët Australinë, Japoninë, Zelandën e Re dhe Korenë e Jugut, si dhe Bashkimin Evropian.

Sekretari i Përgjithshëm Mark Rutte tha se kjo ishte “një shenjë e qartë e thellimit të bashkëpunimit tonë përballë sfidave të përbashkëta”.

Ministrat diskutuan përpjekjet e përbashkëta për të nxitur mbrojtjen kibernetike, prodhimin e mbrojtjes dhe inovacionin; kundër dezinformatave; dhe të shfrytëzojë teknologjitë e reja, duke përfshirë inteligjencën artificiale. Ata gjithashtu u konsultuan se si po punojnë së bashku për të mbështetur Ukrainën.

“Lufta në Ukrainë ka treguar se paqëndrueshmëria në Evropë mund të ketë pasoja të mëdha në mbarë botën dhe se vendet mijëra milje larg – aq larg sa Irani, Kina dhe madje edhe Koreja e Veriut – mund të bëhen prishës të sigurisë në oborrin tonë. Bota jonë është e lidhur ngushtë – dhe po ashtu edhe siguria jonë”, - tha Rutte, i cili kryesonte Takimin e tij të parë të Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s që nga marrja e detyrës në fillim të këtij muaji.

Sekretari i Përgjithshëm u takua gjithashtu me presidentin ukrainas Volodymyr Zelenskyy për të diskutuar mbështetjen e vazhdueshme për Ukrainën.

Presidenti Zelenskyy më vonë iu drejtua Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s në Këshillin NATO-Ukrainë, duke përshëndetur mbështetjen e vazhdueshme të NATO-s dhe duke theksuar nevojat më urgjente të Ukrainës.

Sekretari i Përgjithshëm nënvizoi se Aleatët janë në rrugën e duhur për të përmbushur premtimin e tyre financiar prej 40 miliardë euro në ndihmë të sigurisë për Ukrainën, me 20.9 miliardë euro të dhëna në gjysmën e parë të këtij viti.

Z. Rutte vuri në dukje gjithashtu udhëtimin e tij të fundit në Wiesbaden, Gjermani, ku ai vizitoi komandën e re të NATO-s për të koordinuar ndihmën dhe trajnimin e sigurisë në Ukrainë. Ai tha se burrat dhe gratë që shërbejnë atje “tashmë janë duke punuar shumë për të siguruar që ne të ofrojmë për Ukrainën - në mënyrë që ju të mund të mbizotëroni”.

NATO nis pesë nisma të reja bashkëpunimi shumëkombëshe që rrisin parandalimin dhe mbrojtjen

NATO nisi pesë iniciativa të dizajnuara për të adresuar disa nga fushat më kritike për parandalimin dhe mbrojtjen e Aleatëve. Këto projekte të reja shumëkombëshe me dukshmëri të lartë do të përfshijnë gjithsej 26 aleatë dhe do të ndihmojnë në ofrimin e aftësive kritike që do të rrisin ndërveprimin midis forcave të NATO-s.

Aleatët kontribuues morën pjesë në një ceremoni nënshkrimi gjatë një takimi të Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s në selinë e NATO-s. Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm në detyrë i NATO-s, Boris Ruge përshëndeti “fillimin e një pune më kuptimplote në fusha të reja, por edhe piketa të rëndësishme për projektet ekzistuese”, duke shtuar se “është një shembull i shkëlqyer se si Aleanca jonë ofron”.

Projekti i parë synon të përshpejtojë shpërndarjen e Sistemeve të Avionëve të Pilotuar nga Distanca (RPAS) të gjeneratës së re - siç është Mbikëqyrja Tokësore e Aleancës së NATO-s (AGS) - përmes bashkëpunimit shumëkombësh. Trembëdhjetë aleatë filluan projektin: Çekia, Estonia, Finlanda, Greqia, Italia, Letonia, Lituania, Norvegjia, Portugalia, Rumania, Spanja, Turqia dhe Mbretëria e Bashkuar. Flotat RPAS janë thelbësore për një sërë rolesh dhe misionesh duke përfshirë inteligjencën e përbashkët, vëzhgimin dhe zbulimin dhe luftën elektromagnetike.

Nisma e dytë synon të rrisë këmbësorinë dhe ndërveprueshmërinë e municioneve kryesore të artilerisë aleate. Me kontributet fillestare nga 15 aleatë - Çekia, Danimarka, Finlanda, Franca, Greqia, Hungaria, Italia, Letonia, Lituania, Norvegjia, Portugalia, Sllovakia, Turqia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara - projekti do të kontribuojë në harmonizimin e testimit kombëtar të zjarrit dhe mekanizmat e certifikimit. Ai gjithashtu do të ndihmojë në mbajtjen e standardeve përkatëse të përditësuara dhe do të mbështesë miratimin e tyre.

Projekti i “Distributed Synthetic Training Environment” synon t’i përgjigjet kërkesës gjithnjë në rritje për trajnime virtuale në nivel shumëkombësh. Ai krijon një rrjet të mundësive të avancuara dhe gjithëpërfshirëse të trajnimit shumëkombësh për ushtarakët. Tetëmbëdhjetë vende të NATO-s i janë bashkuar projektit: Belgjika, Çekia, Danimarka, Estonia, Franca, Gjermania, Greqia, Italia, Letonia, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Spanja, Suedia, Turqia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara. Duke shfrytëzuar aftësitë kombëtare të trajnimit të simuluar për qëllime shumëkombëshe, projekti do të sjellë përfitime të jashtëzakonshme operacionale dhe ekonomi të shkallës.

NATO po rrit më tej përpjekjet e saj për të mbështetur shpërndarjen aleate të teknologjive hapësinore me dy projekte të reja. Njëpërmjet NORTHLINK, 13 aleatë - Kanadaja, Danimarka, Finlanda, Franca, Gjermania, Hungaria, Islanda, Italia, Luksemburgu, Holanda,



“LUFTA NË UKRAINË KA TREGUAR QË PAQËNDRUESHMËRIA NË EUROPEË, MUND TË KETË PASOJA SHUMË TË FORTA NË GJITHË BOTËN DHE VENDE, QË NDODHEN MIJËRA KILOMETRA LARG, SI IRANI, KINA DHE KOREJA E VERIUT, MUND TË PËRBËJNË SFIDA TË SIGURISË NË ‘OBORRIN TONË’. BOTA JONË ËSHTË E LIDHUR NGUSHTË DHE PO AQ NGUSHTË ËSHTË E LIDHUR EDHE SIGURIA JONË”, SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I NATO-S.

Norvegjia, Suedia dhe Shtetet e Bashkuara - do të eksplorojnë zhvillimin e një komunikimi satelitor shumëkombësh të Arktikut të sigurt, me aftësi, elastik dhe të besueshëm.

Njëpërmjet nismës STARLIFT, 14 vende - Belgjika, Finlanda, Franca, Gjermania, Hungaria, Italia, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Spanja, Suedia, Turqia, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara - do të hetojnë mënyrat për të forcuar aksesin e NATO-s dhe përdorimin e hapësirë për t’u marrë me një sërë sfidash që vijnë nga operimi nga hapësira. STARLIFT mund t’i ndihmojë aleatët të nisin asetet me një njoftim të shkurtër, të manovrojnë një anije kozmike rezervë të paravendosur ose të blejnë të dhëna nga partnerët tregtarë gjatë krizës ose konfliktit.

U ndërmorën gjithashtu hapa të mëtejshëm për të çuar përpara punën në dy projekte tashmë në zhvillim: Kapaciteti i “Rotorcraft” i Gjeneratës së ardhshme (NGRC) dhe bashkëpunimi ndërkufitar i hapësirës ajrore të NATO-s. E nisur në vitin 2020 dhe e menaxhuar nga Agjencia e Mbështetjes dhe Prokurimit të NATO-s (NSPA), iniciativa NGRC synon të zëvendësojë aftësitë mesatare me shumë role, duke i dhënë fund ciklit të tyre jetësor në 2035 dhe më tej. Të enjten, pesë nga aleatët pjesëmarrës - Franca, Gjermania, Italia, Holanda dhe Mbretëria e Bashkuar - u angazhuan për të identifikuar një zgjidhje të vetme të preferuar për zëvendësimin e këtyre aftësive deri në fund të vitit 2027, duke mundur kështu zhvillimin e kësaj zgjidhjeje në 2030.

Nisma e hapësirës ajrore ndërkufitare e NATO-s u rrit gjithashtu në 20 vende anëtare me shtimin e Danimarkës, Gjermanisë, Islandës dhe Portugalisë. I nisur për herë të parë në tetor 2023, projekti synon të nxisë bashkëpunimin civilo-ushtarak për përdorimin e hapësirës ajrore për trajnime dhe stërvitje të NATO-s dhe aktivitete të tjera ajrore në disa rajone të Evropës.

NATO rrit ndarjen e sigurt të të dhënave në mbarë Aleancën
NATO nisi një iniciativë të re për të nxitur ndarjen e sigurt të të dhënave me shpejtësi dhe shkallë për të rritur më tej ndërgjegjësimin e situatës dhe vendimmarrjen e drejtuar nga të dhënat.

Ekosistemi i Aleancës për Ndarjen e të Dhënave (ADSE) për

mbrojtjen dhe sigurinë do të mbështesë zbatimin e transformimit dixhital të NATO-s dhe përpjekjet e saj në adoptimin e shpejtë të teknologjive me përdorim të dyfishtë. Ai do të përdorë aftësitë ekzistuese në të gjithë Ndërmarrjen e NATO-s, agjencitë qeveritare aleate, industrinë dhe akademinë, dhe aktorë të tjerë kryesorë. Faza pilot do të zgjasë deri në fund të vitit 2025 dhe fillimisht do të fokusohet në të dhëna publike dhe të paklasifikuara për të mbështetur katër fusha prioritare: sigurinë e infrastrukturës kritike nënujore; ndërgjegjësimi gjeohapësinor; vlerësimi i mjedisit të informacionit dhe ndërgjegjësimi për situatën detare.

Lidhja e ADSE-së me iniciativat e tjera për ndarjen e të dhënave, të tilla si Mbikëqyrja e Përherëshme e Aleancës nga Hapësira, do të ketë një efekt shumëfishues në aftësinë e NATO-s për shfrytëzimin e të dhënave dhe operacionet me shumë domene.

Nisma e re është në kohën e duhur. Konkurrentët strategjikë po përshpejtojnë shfrytëzimin e të dhënave në fushën ushtarake dhe civile, veçanërisht për zhvillimin e aftësive të aktivizuara nga AI-ja. Disponueshmëria e të dhënave cilësore të gatshme për AI-në është një parakusht që NATO të ruajë avantazhin e saj teknologjik dhe efektivitetin ushtarak.

Zhvillimet e ditës së dytë të takimit të ministrave të Mbrojtjes në Bruksel, u hapën me mbledhjen e Këshillit të Atlantikut të Veriut në seancën e Ministrave të Mbrojtjes, ku u vazhduan temat e vendimeve të marra nga liderët e NATO-s, në samitin e Uashingtonit, për forcimin e parandalimit dhe mbrojtjes, në investimin e forcave të duhura në përballje e sfidave me të cilat po përballlet Aleanca. “Ne po përforcojmë kapacitetin e industrisë së mbrojtjes dhe prodhimit në të gjithë Aleancën, njëkohësisht kur ne po punojmë në mbrojtjen e zinxhirit kritik të furnizimit, ne po përforcojmë në mënyrë shumë domethënëse mbështetjen për Ukrainën, në mënyrë që të luftojë e të mbrohet kundrejt agresionit rus, sot, dhe të parandalojë kërcënimet e mundshme të Rusisë në të ardhmen. Ne vazhdojmë të promovojmë stabilitet dhe siguri në të gjithë Aleancën tonë, duke përfshirë misionet dhe operacionet, nga KFOR-i e deri te misioni i NATO-s në Irak”, - u shpreh Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte.





GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ:
EKSPERT PËR SK, RAJONIN DHE NATO-n

Një përmbledhje strategjike mbi oportunitetet dhe rreziqet më kritike për individin, shkencën, shoqërinë njerëzore, kulturën dhe rendin botëror, pra rreth: “Inteligjencës Artificiale”, duke iu referuar filozofit më të shquar të historisë moderne të njerëzimit, Prof. Yuval Noah Harari:

- Inteligjenca Artificiale (AI) po arrin në kufijtë e shoqërizimit, duke influencuar ndjenjat/lidhjet emocionale, sociale, madje edhe vetë kuptimin e ekzistencës tonë. Nga ana tjetër, “një set pyetjesh të forta” ngrihen mbi AI-në, të cilat po dominojnë diskutimet akademike, shkencore, politike, zyrtare dhe shoqërinë njerëzore: çfarë oportunitetesh dhe kërcënimesh paraqet AI-ja për ardhmërinë e njerëzimit? Referuar edhe Biblës: “A do përbënte AI-ja një betejë kundër natyrës, bashkë me të, fundin e historisë së njerëzimit”? A është e mundur? A do të jetë në gjendje shoqëria njerëzore të prodhojë mekanizmat e duhura për të adresuar përfitimet si dhe për t’u mbrojtur sa nuk është vonë nga AI-ja?

Dekadën e fundit, Institucionet e sigurisë në rrafshin kombëtar dhe Global, mbeten të fokusuar mbi pasojat e riciklimit të luftës neonaziste të Rusisë – Putiniste për pushtimin e Ukrainës; përballjen me terroristët e pafe në Lindjen e Mesme; sfidat e paqes në Ballkanin Perëndimor; programet e armëve të shkatërrimit në masë në Korenë e Veriut, Iran, krizën ekologjike, me të cilat po përballen njerëzimi. Për mirë apo për keq, edhe AI-ja po demonstroi peshë gjithnjë e me përcaktuese në të gjitha sa përmendëm, si dhe për të përmirësuar ose përkeqësuar edhe sistemin ekologjik 4 miliardë vjeçar të planetit Tokë. Në fakt, frikësimi i njerëzimit nga AI-ja ka nisur bashkë me epokën e kompjuterit nga mesi i shekullit të 20-të, me shfaqjen e filmave fantastiko-shkencor, “Terminator” ose “Matrix”. Por ndërkohë që shkenarët fantastiko-shkencor janë bërë pika referimi kulturorë, ata nuk janë marrë seriozisht në debatet shkencore, politike, etj. Inteligjenca Artificiale po përparon frikshëm, deri në kufijtë për t’u bërë e ndjeshme, pra zotërimin e ndjenjave dhe ndërgjegjes, ose të bëhet e aftë për të influencuar kulturën dhe botën fizike. Dhe ndoshta më shpejt seç mendohet, robotët do të jenë në gjendje të lëvizin dhe të veprojnë në shtëpi, qytete, male, pyje, ekonomi, shkencë, mjekësi, hapësire, ushtri, polici, etj., edhe më me efikasitet sa dhe vetë Ne/njerëzit. Gjithsesi, edhe për Chat GPT apo të tjera teknologji të reja të AI-së, ende nuk kanë prova që ato të zotërojnë vetëdije, emocione, etj., si p.sh. data që automjetet vetëdrejtojnë, vazhdon të shtyhet. “Lajmi i keq” është se për të kërcënuar mbijetesën e qytetërimit tonë, AI-ja nuk ka nevojë për ndërgjegje. Ndryshe nga sa mund të mendohet, AI-ja është në gjendje të mësojë dhe përmirësohet vetë, deri në masën sa vetë zhvilluesit e këtyre mjeteve suprizohen me aftësitë e plota të AI-së!? Prandaj, Harari parashikon që me këto aftësi AI, rrezikon të “gllabërojë deri edhe kulturën njerëzore”. Tashmë jemi të familjarizuar për disa nga aftësitë më themelore që zotëron AI-ja, si ato të shkrimit të tekstit, vizatimit të imazheve, kompozimit të muzikës, fjalimeve politike, hapjes së kodeve, etj. Por, ka shumë aftësi shtesë që po shfaqen si falsifikim i thellë i zërave dhe imazheve (Deep Fake), kontratat ligjore, deri aftësitë për të “rekomanduar” marrëdhënie intime mes qenieve njerëzore. Aspekti më i rëndësishëm i revolucionit të AI-së, është zotërimi i gjuhës në një nivel që tejkalon edhe aftësinë njerëzore! Por me zotërimin e gjuhës njerëzore, AI-ja “kërcënon të depërtojë në çelësat” që ç’ bllokojnë dyert e institucioneve, bankave, e-mailit, FB, etj. Ndërsa kështu, AI-ja është shumë afër për të hakuar përdorim e gjuhës dhe për të krijuar mitologji, ligje, art, shkencë, politikë, deri për të bashkëjetuar miqësisht me “njeriun tokësor”! Nëpërmjet zotërimit të gjuhës, AI-ja gjithashtu mund të krijojë marrëdhënie intime (ndërvarësie) me njerëzit dhe për të ndikuar në opinionet dhe pikëpamjet tona mbi botën. Që AI-ja të ketë ndërgjegje, nuk ka nevojë për ndjenjat e veta, pasi (keq) përdor vartësinë njerëzore ndaj AI-së.

Kështu, AI-ja ka ngritur një pyetje të madhe: “çfarë do të thoshte për qeniet njerëzore të jetonin në një botë ku ndoshta shumica e tregimeve, meloive, imazheve, ligjeve, politikave dhe mjeteve janë formësuar nga Alienët, pra jo-njerëzore, të cilët ditën të shfrytëzonin me efikasitet, dobësitë dhe ka arritur të krijojnë marrëdhënie, madje intime me qeniet njerëzore”? Sot, asnjë njeri nuk mund të shpresojë të mundë një kompjuter në lojën e shahut! E njëjta gjë po ndodh në art, në politikë, ekonomi, arsimim, sport, muzikë, shëndetësi, etj. Çfarë do të ndodhë me sistemin arsimor, kur fëmijët të shkruajnë esetë e tyre me Chat GPT (?) etj. Së shpejti mund ta gjejmë veten duke zhvilluar diskutime në internet për abortin, ndryshimin e klimës, apo përballjen me entitete që ne mendojmë se janë qenie njerëzore, por në të vërtetë mund të jenë Robotë të AI-së. A nuk do ishte krejtësisht e kotë, që ne të humbim kohën tonë, duke u përpyetur të bindim një Robot të AI-së të ndryshojë pikëpamjet

Inteligjenca Artificiale, fati apo fundi i njerëzimit?!



e tij, pasi sa më gjatë të kalojmë, duke folur me Robotin, aq më mirë ai na njeh si dhe më lehtësisht i përpunon mesazhet për të na ndryshuar pikëpamjet tona politike dhe në çdo fushë tjetër. Në qershor 2022 ndodhi një incident i famshëm kur inxhinieri i Google, “Blake Lemoine”, i cili deklaroi publikisht se Chatbot-i/ AI, “Lambda” (për të cilin ai punonte) u bë një qenie e ndjeshme që reagoi ndaj tij. Por Profesori humbi punën shumë fitimprurëse, pikërisht kur mendonte se po mbronte Chatbot-in e AI-së. Çfarë do të ndodhë me shoqërinë njerëzore ndërsa AI-ja po përparon në një betejë për të krijuar marrëdhënie intime me Ne/njeriun, që më pas mund të përdoren për të na bindur të blejmë produkte të veçanta, ose të votojmë për Parti ose politikanë të veçantë apo deri edhe me kë të martohem?!

Sot njerëzit mund të përdorin një këshilltar të vetëm të AI-së, si “Oracle” me një ndalesë (one stop shop) dhe si burim për të gjithë informacionin që u nevojitet. Pse të shqetësoheni për të kërkuar diçka kur thjesht mund t’i kërkonit “Oracle-it” t’ju tregojë gjithçka që dëshironi? Pra, ekziston mundësia që brenda një kohe të shkurtër e gjithë industria e reklamave të shembet, ndërsa AI-ja si dhe pronarët dhe kompanitë që kontrollojnë AI-në do të bëhen jashtëzakonisht të pasur dhe rrjedhimisht më të fuqishëm. Pra kjo për të cilën po flasim, potencialisht nuk është fundi i historisë njerëzore, por fundi i pjesës së dominuar nga njeriu.

Brenda pak vitesh Inteligjenca Artificiale mund të memorizojë/ përvetësojë të gjithë historinë e kulturës njerëzore, pra gjithçka u prodhua për mijëra e mijëra vjet. Mos të harrojmë se Ne/njerëzit nuk kemi njëherë e përgjithmonë të drejtë për realitetin. Mjetet e mëparshme si shtypshkronjat, radiot, apo televizorët ndihmuan në përhapjen e kulturave, por ato kurrë nuk mund të krijonin diçka të re vetë. Një shtypshkronjë nuk mund të krijojë një libër të ri, atë e bën/te vetëm njeriu. Prandaj, AI-ja është thelbësisht e ndryshme nga makinat e shtypit, nga radiot, nga çdo shpikje e mëparshme në histori, pasi AI-ja mund të krijojë ide, histori, imazhe, realitete krejtësisht të reja dhe kështu mund të krijojë një kulturë të re, apo Jo?

Së shpejti, Ne/njerëzit mund ta gjejmë veten duke jetuar brenda ëndrrave dhe fantazive që janë thelbësisht të ndryshme nga shumica e gjërave të imagjinuara në filma dhe libra fantastiko-shkencorë. Më parë njerëzit kishin frikë nga kërcënimet fizik që paraqesin makinat inteligjente, që mund të vraponin rrugëve dhe qëllonin/vrisnin. Ndryshe nga disa teori konspirative, AI-ja nuk ka nevojë të dërgojë Robotë vrasës, pasi AI-ja mund t’i influencojë lehtësisht njerëzit të tërheqin këmbëzën nëse/kur ka nevojë ...!

Që nga kohërat e lashta, njerëzit kishin frikë se mos ishin të bllokuar në një botë iluzionesh. Në Greqinë e lashtë, Platoni tregoi alegorinë e shpellës, ku një grup njerëzish të lidhur me zinxhirë gjatë gjithë jetës së tyre përballë një muri të zbrazët, ose ekrani le të themi. Me vonë Buda tha se: “ajo që Ne normalisht e konsiderojmë realitet është shpesh vetëm trillime në mendjet tona”. Njerëzit kanë bërë luftëra të tëra duke vrarë dhe duke qenë të gatshëm të vriten vetë, për shkak të besimit të tyre në këto trillime!

Pra, revolucion i AI-së do/po na sjell ballë për ballë me demonin e shpellës së Platonit dhe Budës, nëse nuk do të jemi në

gjendje ta heqim këtë perde iluzionesh, duke menduar se ky është realitet. Megjithatë, këto mjete të Inteligjencës Artificiale kanë qenë të mjaftueshme për të krijuar këtë lloj perde iluzionesh që rrisin polarizimin shoqëror, minojnë shëndetin mendor dhe besimin te vlerat e shoqërisë demokratike.

Mesazhe përmbledhëse, pa mëdyshje, që Inteligjenca Artificiale (AI) mbart potenciale të jashtëzakonshme pozitive, si p.sh në gjetjen e kurave ndaj kancerit, etj.; zhvillimin e ekonomisë dhe mirëqenies, për paqen dhe sigurinë; kapërcimin e krizës ekologjike, etj., sfida me të cilat po përballen shoqëria njerëzore. Në 1945, në Hiroshima u provua fuqia shkatërruese e bombës atomike. Por a nuk do përfitonte njerëzimi duke prodhuar në vend të bombave energji të lirë dhe të bollshme? Kështu na duhet të mendojmë edhe për këtë armë të re (AI), që nëse nuk e vendosim nën rregulla/kontroll Sot, në vend të përfitimeve, mund të asgjësojë botën tonë mendore dhe bashkë me të njerëzimin.

Prandaj Qeveritë duhet të ndalojnë përdorimin e çdo programi të ri përpara se AI-ja të dalë jashtë kontrollit. Hapi i parë është rregullimi ligjor i (sh) përdorimit të programeve të AI-së në shkollat publike. Ndërsa për censurën në internet, “Twitter”, “Facebook”, “Tik-Tok”, etj., duhet marrë në konsideratë që vetëm qeniet njerëzore kanë lirinë e shprehjes, Robotët nuk e kanë gjithsesi. Kështu që, nëse i vendosim nën kontroll që Sot, ose iu “mohojmë lirinë e shprehjes Robotëve”, mendoj se kjo duhet të jetë shumë mirë me të gjithë, apo Jo?

Në botën që rrokulliset me konflikte kaotike, AI-ja perceptohet si: “zgjidhja/mallkimi jashtëtokësor” drejt fundit të historisë njerëzore, edhe pse për të kërcënuar themelet e qytetërimit nuk ka gjithsesi nevojë për Inteligjencën Artificiale...! Diktaturat, ekstremizmi i -do lloj forme, rikthimi te lufta neo-Naziste, armët bërthamore, dezinformimi nga mediat, etj., janë prova të vetë-mjaftueshme për të krijuar kaos social, politik, Qeverisës, vlerave si dhe për të hedhur në greminë shoqërinë njerëzore.

Padyshim që me gjithë zhvillimet e sipërpërmendura, AI-ja mbetet ende artificiale, në kuptimin që Ne/njerëzit e prodhojmë. Por është po ashtu fakt që AI-ja prodhon gjithnjë e më shumë vetveten, pra po del jashtë kontrollit tonë! Atëherë gjëja më e rëndësishme është të kuptojmë me të vërtetë se me çfarë po përballemi dhe të mos ngushëllojmë veten me mendime delirante, si p.sh: “AI-ja është produkti Ynë/njeriut, pra është nën kontrollin Tonë të plotë, dhe nëse përpigjet të bëjë diçka të gabuar Ne e heqim nga priza ...”, etj., si këto. Përveç frikës se mund të na shkatërrojë qytetërimin, ende nuk dimë qartësisht për këtë “inteligjencë të huaj”. Prandaj duhet ndaluar zhvillimi i pakontrolluar i kësaj inteligjence, le ta quajmë Aliene, përpara se AI-ja të na rregullojë apo shfarosë Ne/njerëzimin! Por kjo ka nevojë për vullnet dhe Leadsip të fortë si dhe fuqi kompjuterike shtesë, pra për më shumë para.

Ndërsa si mesazh përmbyllës: “Inteligjenca Artificiale (AI) mbetet si një thikë me dy presa”, pasi mbart përfitime por edhe rreziqe të jashtëzakonshme për shoqërinë njerëzore. Kështu që, fati apo fundi i njerëzimit varet nga vendimet dhe veprimet që shoqëria do ndërmarrë përpara se AI-ja të dalë jashtë kontrollit.

Forcat Speciale, heronjtë e heshtur të Forcave të Armatosura

Batalioni i Forcave Speciale është krijuar me Vendim të Këshillit të Mbrojtjes nr.2, datë 16 tetor 1998. Qëllimi kryesor i krijimit të kësaj njësie ishte që të krijohej një forcë elitë e kombit që të përballonte turbulencat politike, ekonomike e ushtarake që po kalonte vendi pas viteve '90, siç ishte rasti i pa precedentë i sulmit të organizuar ndaj repartit të Peshkëpisë, ku humbën jetën disa ushtarakë, apo ngjarjet e 97-ës, të cilat destabilizuan vendin. Kjo njësi u krijua pikërisht me qëllimin e vetëm të kalonte vijën e operacioneve klasike konvencionale, duke patur në gjirin e saj operatorë specialë, të aftë të vepronin me grupe të vogla në fshehtësi të plotë, por me efekt të madh për interesat e vendit. Kjo njësi do të operonte brenda dhe jashtë vendit në luftën kundër terrorizmit dhe formave të tjera të kërcënimeve, kur lypset nevoja dhe të përdorej si aset i rëndësishëm i FA-ve për të kryer detyra direkte, zbulim special apo asistencë ushtarake gjë që forcat e tjera konvencionale nuk i përmbushnin dot. Vendi i dislokimit të forcave speciale fillimisht ishte në rajonin e Farkës dhe momentalisht ndodhet i dislokuar në Zall-Herr, Tiranë.

Aktiviteti i Forcave Speciale

Aktivitetin repartit e ka filluar, më datë 24.02.1999, dhe ishte i përbërë nga Shtabi dhe 4 grupe speciale. Komandanti i parë i Batalionit Special ka qenë Kolonel Hysen Ymeri, një nga zbuluesit më të mirë të ushtrisë, i cili ka dhënë një kontribut mjaft të çmuar në ngritjen dhe zhvillimin e kësaj njësie.

Krijimi i forcave speciale u konsiderua i një rëndësie të veçantë, sepse për herë të parë Forcat tona të Armatosura kishin në gjirin e vet një njësi elitë e aftë të vepronte në tre dimensionet tokë-ajër-det për t'i paraprirë çdo lloj forme kërcënimi apo rreziku me një shpejtësi dhe aftësi të jashtëzakonshme.

Forcat Speciale dhe rëndësia e tyre

Rreziqet kombëtare po afirmohen gjithnjë e më shumë si modele asimetrike e hibride dhe përballja ndaj tyre kërkon metoda të veçanta që kalon përtej koncepteve konvencionale. Të gjitha këto ndryshime në qasjen me sigurinë dhe format hibride që po përdorin vende si Rusia, kryesisht ndaj vendeve Baltike dhe Ballkanit perëndimor, na dikton nevojën për të patur forca speciale të afta të përgjigjen në çdo kohë këtyre ndryshimeve. Mjedisi i sotëm strategjik karakterizohet, si kurrë ndonjëherë më parë, nga e panjohura dhe nga e pa parashikuara. Skena e sigurisë botërore influencohet, përditë e më tepër nga shtete autokrate dhe organizata terroriste, të cilat po arrijnë të krijojnë rreziqe e kërcënime për sigurinë e përgjithshme mbarë botërore.

Konflikti i fundit mes Izraelit dhe organizatës terroriste të Hamas apo ai Rusi-Ukrainë, kanë nxjerrë në pah domosdoshmërinë e zhvillimit dhe integritetit të forcave speciale në këtë mjedis, duke përqafuar metodat, konceptet dhe teknologjitë e fundit të përdorura në këto luftime.

Si është i organizuar ky batalion?

Forcat Speciale, sipas doktrinë së NATO-s, SOF dhe kushteve e kërcënimeve në mjedisin e sigurisë rajonal e global, konsiderohen asete strategjike të një vendi. Ato janë njësi të specializuara, të mirë organizuara, të mirë trajnuara dhe të kompletuara me personel të përzgjedhur në bazë të një trajnimit të gjatë taktiko-psikologjik dhe të aftë për t'u përshtatur me metodat jo-konvencionale në qasjen me objektivin. Këto operacione mund të kryhen në një spektër të plotë në një mjedis të përbashkët operacional, të pavarura ose me forcat konvencionale, për të ndihmuar të arrijë gjendjen e dëshiruar.

Batalioni special është i organizuar e strukturuar në bazë të reformimit të fundit të gjithë FA-së dhe është pjesë e Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS), duke patur në organikë kompani të operacioneve speciale me drejtim tokë-ajër-det, e aftë të planëzojë e zhvillojë operacione speciale me spektër të plotë në një mjedis të përbashkët operacional. Batalioni special zotëron aftësi dhe kapacitetet e nevojshme të përmbushë me sukses tre detyra bazë që janë aksionet Direkt (AD), Asistencë ushtarake (AU) dhe Zbulim Special (ZS).

Batalioni Special zotëron teknologjinë e fundit të pajisjeve dhe modernizimit simjete të shikimit natën, shënjestër lazer për armët, kamera termale dhe mjete motorike ujore të gjeneratës së fundit që mundësojnë këtë njësi të përmbushë të gjitha detyrat specifike që i ngarkohen.

Batalioni special është njësi unike në llojin e vet pasi operon në tre drejtimet si tokë-ajër-det, në një konceptim krejtësisht ndryshe nga kapacitete konvencionale. Kjo nënkupton që batalioni special duhet të balancojë dhe modernizojë të gjitha këto kapacitete në të tre drejtimet. Por mbetet sfida akoma për t'u zhvilluar kapaciteti ajror pasi në konceptet dhe doktrinat e NATO-s, SOF, çdo njësi e forcave special duhet të zotërojë asetet e veta ajrore të dedikuara për operacionet speciale. Kjo njësi aktualisht nuk i ka në dispozicion kapacitetet ajrore, por ka planifikuar t'i ketë në të ardhmen e afërt



këto kapacitete. Por, gjithsesi ky kapacitet mund të ofrohet edhe nga vendet aleate nëse e kërkon nevoja për t'u dislokuar në komandat e SOCC të operacioneve speciale. Gjithashtu në rekomandimet e komandës së SOFCOM në NATO SHAPE apo në doktrinat bazë të SOF si AJP3.5, forcat speciale duhet të kenë komandim-kontroll të shkurtër dhe të qartë në mënyrë që të sigurohet pavarësia dhe të mos dekonspirohet operacioni. Pra rekomandohet që varësia e Forcave Speciale të jetë direkt nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm. Misionet e forcave speciale ndryshojnë nga ato klasike konvencionale nga metoda e qasjes me objektivin. Në mjedisin e sotëm të sigurisë po gjenerohen gjithnjë e më shumë metoda asimetrike të luftës dhe kjo situatë kërkon medoemos përdorimin e forcave speciale pasi misionet klasike konvencionale nuk mund të jenë efektive në këtë mjedis. Misionet e forcave speciale janë më pak të kushtueshme, pasi vetëm një grup i vogël operatorësh mund të kryejnë detyra me efekt operacionalo-strategjik për vendin.

Konsideratat politiko-ushtarake mund të kërkojnë operacione klandestinë ose teknikat e fshehta dhe pranimin e një shkalle të lartë rreziku politik apo ushtarak që nuk mund të realizohet me operacione nga forcat konvencionale.

Pse operacionet speciale janë unike?

Operacionet speciale janë unike, sepse ofrojnë zgjidhje strategjike të problemeve ose i shërbejnë nivelit operacional dhe plotësimit të objektivave politike.

Disa karakteristika të forcave speciale

- Forcat speciale janë, nga natyra, bashkëpunuese dhe të gjithanshme. Forcat speciale FS janë organizuar në mënyrë të tillë që të bashkëpunojnë me forcat ajrore, forcat detare dhe

tokësore nga vendet kontribuuese të trupave (TCNs), që përbëjnë një direktivë speciale të veçantë për misionin komandën e komponentëve të operacioneve (SOCC), me një staf të përbashkët për të planifikuar dhe drejtuar operacione speciale.

- Forcat speciale të NATO-s konsiderohen asete strategjike për t'u përdorur dhe menaxhuar për arritjen e objektivave strategjike dhe në disa raste të zhvillojnë detyra në nivel operativ. FS janë të organizuar përmes një SOCC, që së bashku me komandat e komponentëve të forcave tokësore, ajrore dhe detare qëndron në gatishmëri për misione të ardhshme.

Karakteristikat dhe cilësitë e forcave ushtarake

Forcat speciale janë bashkëpunuese dhe të gjithanshme. Forcat speciale janë organizuar në mënyrë të tillë që të bashkëpunojnë me forcat ajrore, forcat detare dhe tokësore nga vendet kontribuuese të trupave (TCNs), që përbëjnë një direktivë speciale të veçantë për misionin, komandën e komponentëve të operacioneve (SOCC), me një staf të përbashkët për të planifikuar dhe drejtuar operacione speciale.

Forcat speciale të NATO-s konsiderohen asete strategjike për t'u përdorur dhe menaxhuar për arritjen e objektivave strategjike dhe në disa raste të zhvillojnë detyra në nivel operativ. FS janë të organizuar përmes një SOCC që së bashku me komandat e komponentëve të forcave tokësore, ajrore dhe detare qëndron në gatishmëri për misione të ardhshme. Operacionet speciale zhvillohen në një zonë të përbashkët operacionesh (JOA) me forcat e tjera ajrore, tokësore dhe detare. Në këtë kontekst një komandanti të nivelit operativ i krijohet efekt i madh sinergjik me unitetin e komandës, integrim në nivel operacional të forcave dhe të sigurojë



mbështetje për forcat e tjera të NATO-s.

Operacionet speciale zakonisht kryhen me risk të lartë pasigurie në mjedis krejtësisht armiqësor dhe me sensibilitet të lartë politik, duke krijuar efekte që mbështesin arritjen e objektivat gjithëpërfshirëse strategjike-operacionale. Këto operacione zhvillohen duke përdorur aftësitë dhe teknikat të fshehta infiltruese dhe kërkojnë pjekuri dhe trajnim maksimal për shkak se dështimi ka efekte politike. Operacione speciale mund të zhvillohen në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me forcat konvencionale dhe mund të përfshijnë bashkëpunim dhe planëzim të përbashkët ndërinstitucional si me forcat tona po ashtu edhe forcave indigjene ose ato rezervë.

Ndryshimi i misioneve konvencionale nga ato speciale

Operacionet speciale ndryshojnë nga operacionet konvencionale për vetë shkallën e rrezikut politik, teknikat operacionale, mënyrat si bëhet qasja me objektivin, varësia nga inteligjenca e detajuar operacionale dhe përdorimi i faktorëve indigjenë. Operacionet speciale janë unikë në llojin e vet, sepse varen shumë nga cilësitë aftësitë taktike-fizike e psikologjike të operatorëve specialë që mund të krijojnë kushte shumë të favorshme për faktorin konvencional në një komandë të bashkuar operacionale. Operacionet speciale zhvillohen në thellësi të prapavijës së kundërshtarit dhe veprojnë në fshehtësi të plotë, duke i shkaktuar dëme psikologjike atij.

Parimet e operacioneve speciale

Tempo e lartë operacionale, ku shpejtësia dhe objektivi janë të lidhura pazgjidhshmërisht, pasi mund të gjendesh nën presionin e kohës për neutralizimin apo eliminimin e objektivit të kërkuar. Forcat speciale duhen integruar që në gjenezën e një konflikti, pasi janë të afta të ndihmojnë leadershipin ushtarak me këshilla operacionale e strategjike për të analizuar faktorët politik, ekonomik e ushtarakë që ndikojnë në një konflikt.

Operacionet speciale zakonisht merren me forcën e rëndesës së kundërshtarit dhe si objektiva mund të jenë VIP-a civilë ose ushtarakë. Operacionet speciale udhëhiqen nga parimet si fleksibilitet, zhdërvjelltësi dhe përshtatshmëri në mjedisin operacional.

Operacionet speciale zakonisht kryhen me risk të lartë pasigurie në mjedis krejtësisht armiqësor dhe sensibilitet të lartë politik, duke krijuar efekte që mbështesin arritjen e objektivat gjithëpërfshirëse strategjike-operacionale. Këto operacione zhvillohen duke përdorur aftësitë dhe teknikat të fshehta infiltruese dhe kërkojnë pjekuri dhe trajnim maksimal për shkak se dështimi ka efekte politike.

Operacionet speciale mund të zhvillohen në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me forcat konvencionale, të cilat përfshijnë bashkëpunim dhe planëzim ndërinstitucional, si me forcat tona po

ashtu edhe forcave indigjene ose ato rezervë.

Operacionet speciale ndryshojnë nga operacionet konvencionale për vetë shkallën e rreziku politik, teknikat operacionale, mënyrat si bëhet qasja me objektivin, varësia nga inteligjenca e detajuar operacionale dhe përdorimi i faktorëve indigjene.



Operacionet speciale janë unike në llojin e vet sepse varen shumë nga cilësitë aftësitë taktike-fizike e psikologjike të operatorëve specialë që mund të krijojnë kushte shumë të favorshme për faktorin konvencional në një komandë të bashkuar operacionale.

Operacionet speciale zhvillohen në thellësi të prapavijës së kundërshtarit dhe veprojnë në fshehtësi të plotë, duke i shkaktuar dëme psikologjike atij.

Disa prej operacioneve, ku Forcat Speciale të ushtrisë shqiptare kanë qenë të pranishme

Që nga krijimi i tij, ka marrë pjesë në shumë operacione dhe misione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Operacionet e para kanë filluar gjatë konfliktit të Kosovës në vitin 1999. Gjatë kësaj kohe prej gjashtë muajsh grupet speciale të Batalionit Special kanë marrë pjesë aktive në monitorimin e kufirit. Në vitin 2001-2002 grupet Speciale të b.FS morën pjesë në bashkëveprim me forcat e policisë së Shtetit për vendosjen e Rendit Kushtetues dhe qetësisë publike në rrethin e Tropojës, duke kryer shumë shërbime Speciale.

Në vitin 2001 në kohën e konfliktit me armë kundër shqiptarëve të Maqedonisë, katër grupe speciale kanë marrë pjesë në monitorimin e kufirit shtetëror në Republikën e Maqedonisë, si dhe kanë kryer detyra të ndryshme zbulimi.

Në vitin 2003-2004 Batalioni i Forcave Speciale ka marrë pjesë në shumë misione, ku detyrat kryesore kanë qenë monitorimi i gjithë vijës bregdetare, lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore, drogës, armëve në bashkëveprim me forcat e anti-terrorit të Ministrisë së Brendshme, duke bërë të mundur realizimin me sukses të plotë të gjitha misioneve të ngarkuara. Por Forcat speciale kanë zhvilluar disa misione jashtë vendit, si në Irak, Afganistan, Kosovë konkretisht: Në gusht të vitit 2002, deri në shtator te vitit 2004, batalioni i Forcave Speciale ka marrë pjesë në 4 misione paqeruajtëse në Kabul të Afganistanit nën komandën e ISAF.

Nga viti 2005 deri në vitin 2008, batalioni i Forcave Speciale ka marrë pjesë me dy grupe speciale në operacionin “Liria e Irakut”, Mosul, Irak.

Misionet e forcave speciale arritën kulmin e tyre me pjesëmarrjen në misionet luftarake “Eagle” nga viti 2010 deri në vitin 2014, duke zhvilluar gjithsej 8 misione luftarake.

Misioni i Forcave Speciale në mbrojtje të jetës patjetër ka dhe ‘koston’ e vet

Me të gjitha angazhimet e suksesshme në misionet luftarake apo në ato të paqes, Batalioni Special ka patur edhe humbje jete, ku vlen të përmendet heroizmi i Kapiten Feti Voglit, i cili sakrifikoi gjithçka për paqen e sigurinë në botë. Vepra dhe lavdia e tij janë tashmë pjesë e pandarë e aktivitetit tonë të përditshëm si brenda dhe jashtë vendit, duke na shërbyer si frymëzim e krenari për të vijuar plotësimin e ëndrrës së tij për të patur sa më shumë paqe e harmoni në botë.

Forcat speciale sot kanë një vizion të qartë për zhvillimin e rezistencës dhe qëndrueshmërisë kombëtare, duke qenë pararojë e ndryshimeve në mjedisin e sigurisë. Sulmet hibride me strategjitë e fshehura, miksimi i taktikave konvencionale me ato jo-konvencionale, sulmet kibernetike, dezinformimi, lufta psikologjike, na bën të vetëdijshëm mbi rolin e Forcave Speciale

në ngritjen e strategjive të rezistencës kombëtare, shumëzimin e forcave, forcimin e partneritetit publik-privat, komunikimin strategjik dhe qasjen gjithëpërfshirëse me të gjithë aktorët shtetërorë dhe jo-shtetërorë. Jemi të bindur dhe të përgatitur për të përmbushur të gjitha detyrimet tona në kuadër të mbrojtjes së vlerave të padiskutueshme të aleancës sonë NATO, duke u përballur direkt me sfidat dhe kërcënimet asimetrike për të siguruar lirinë e prosperitetin e popujve tanë.



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

...sabotoni fashizmin, bashkëpunoni me partizanët

Në thirrjen e Shtabit të Përgjithshëm drejtuar popullit shqiptar me rastin e kapitullimit të Italisë fashiste, thuhej se "...mobilizimi duhet të bëhet nën flamurin e aleancës sonë me BS, me SHBA, me Anglinë"... "demaskoni e goditni pa mëshirë, bashkë me ushtarët Italian". Ndërsa në "apel ushtrisë italiane" të drejtuar nga Shtabi i Përgjithshëm thuhej: "të luftoni së bashku me ne kundër trupave gjermane". Ende dhe sot pas 81 vitesh dëgjohej dhe është aktuale thirrja e ushtarit Maroi Cristina të Regj. 1 Xhenier, "ju flet nga malet e Shqipërisë një zemër e vërtetë italiane... sabotoni fashizmin, bashkëpunoni me partizanët që luftojnë për lirinë e çdo populli".

Ishin rreth 137 antifashistët italianë të b.p. "Antonio Gramshi" që u organizuan në tre kompani dhe në shtabin e batalionit që ishin komandanti, komisar, intendent dhe korrieri. Komandant i batalionit u caktua Tercilio Kardinali (Terzillio Cardinali) nga San Giovanni Valdarno, një oficer me eksperiencë që kishte luftuar në Afrikë; komisar u caktua një ushtar i Divizionit "Arezzo" me mbiemër Del Ponte, i cili pas një muaji dezertoi nga batalionit dhe humbi gjurmët; intendent u caktua Ermanno Vasari (Ermanno Vasari) nga Montevarchi, një oficer i rangut "graduato" i Divizionit "Arezzo"; dhe korrier u caktua Oskar Nepi (Oscar Nepi), ushtar i thjeshtë nga Lastra a Signa. Nga komandanti i Br.IS, Mehmet Shehu, u orientuan të vepronin të pavarur, por duke iu përmbajtur gjithmonë urdhrave të Komandës së Përgjithshme shqiptare (Shtabit të Përgjithshëm), duke treguar disiplinë të rreptë partizane, si dhe komandantët duhet të shërbenin si shembull. Për t'u orientuar me terrenin dhe për të mësuar taktikën partizane, çdo kompani u shoqërua nga partizanë shqiptarë. Luftimet e para i zhvilloi kundër ballistëve dhe xhandarmërisë shqiptare, për shkak se, njësitë balliste e të xhandarmërisë nuk kishin aftësi të mëdha luftarake dhe thyeshin shpejt. Detyrat kryesore ishin veprime tipike të luftës guerile, si afrimi pranë kazermave apo postë-rojave, asgjësimi i rojave, kapja rob e personelit ushtarak,

Partizanë antifashistë italianë që ranë dëshmorë në Shqipëri



ENDE DHE SOT PAS 81 VITESH DËGJOHET DHE ËSHTË AKTUALE THIRRJA E USHTARIT MAROI CRISTINA TË REGJ. 1 XHENIER, "JU FLET NGA MALET E SHQIPËRISË NJË ZEMËR E VËRTETË ITALIANE... SABOTONI FASHIZMIN, BASHKËPUNONI ME PARTIZANËT QË LUFTOJNË PËR LIRINË E ÇDO POPULLI"

marrja e materialit ushtarak dhe bërja e propagandës për t'i bindur ushtarët ose ballistët që t'u bashkoheshin njërive partizane.

Nga fundi i nëntorit 1943 b.p. "Antonio Gramshi" ishte pothuajse gati për të organizuar aksione në mënyrë të pavarur. Mirëpo kjo nuk ishte dhe aq e lehtë, sepse ushtarët italianë ishin mësuar që të merrnin urdhra nga oficerët, ndërsa tani duhej të vepronin me iniciativën e tyre dhe të merrnin vendime rrufe. Shtabi i Përgjithshëm iu kishte dhënë direktivën dhe njësitë luftarake shqiptare si Br.S dhe b.p. kishin mëvetësi në luftime dhe manovronin me shpejtësi për t'iu shmangur asgjësimit. Në faqet e ditarit të b.p. "Antonio Gramshi" lexojmë se "Shokët janë shumë të kënaqur dhe japin fjalën se do ta kryejnë detyrën deri në fund. Partizanët shqiptarë janë shumë të dashur me ne dhe bëjnë çmos për të na treguar miqësinë e tyre të çiltër, megjithëse kanë vuajtur aq shumë nga fashizmi gjatë pushtimit Italian. Me realizimin me sukses të këtyre sulmeve stërvitëse, batalioni mori detyrë për ngritjen e pritave kundër autokolonave gjermane. Prita e parë u organizua në bashkëpunim me njësitë të tjera të Br.IS

në rrugën Peqin-Elbasan kundër një autokolone me rreth 20 kamionë të shoqëruar nga një auto-blind.

Dëshmorët e parë ranë në mbrojtje të qytetit të Beratit

Në mbrojtjen e qytetit të Beratit, b.p. "Antonio Gramshi", duke qenë të papërgatitur dhe pa eksperiencë për t'u tërhequr me rregull përballë një force të madhe mësymëse gjermane, kompanitë partizane italiane e humbën toruan shpejt dhe u tërhoqën në rrëmujë, duke humbur krejt aftësinë luftarake. Batalioni nuk lëvizi në sektorin që mbronte, në hyrjen veriore të Beratit, kështu që i tëri ra në kurthin e ngritur nga nazistët. Ranë në luftime komisar i batalionit Leo Dalponte dhe partizanët italianë Antonio Pertola, Nino Dino, Ciani Osvaldo, Giuseppe Bonovolte, Guiseppe Voipata, Nikolla Rroka, Vincenko Antonio etj. Partizani italian Rajko Giuseppe ra në Çepan, duke qenë në detyrë infermier, që shërbente si ndihmës i mjekut italian që kuronte e shëronte partizanët e plagosur shqiptarë, në spitalin partizan të Çepanit, të dy u pushkatuan nga forcat balliste me urdhër të komandantit të batalionit ballist, Xhelal



Staraveckës. Komandanti Tercilio Kardinali tregoi trimëri dhe drejtoi batalionin me mjeshtëri derisa batalioni doli nga rrethimi. Pas rrethimit, në atë gjendje jashtëzakonisht të rëndë që u krijua, e pati vështirësi të ruante disiplinën e rregullin. Kështu mbrojtja u shthur dha qëndresa mori fund. Batalioni u copëtua në grupe të vogla dhe secili grup bëri përpjekje për të dalë jashtë qytetit nga drejtime të ndryshme. Por hitlerianët e ballistët kishin zënë të gjitha shtigjet. Duke rënë në këto shtigje shumë veta u vranë ose u kapën robër. Nga b.p. “Antonio Gramshi” kishin mundur të dilnin jashtë rrethimit, natën, gjithsej 48 veta me komandantin e batalionit. Të tërë ata që kishin rënë robër, nazistët gjermanë i pushkatuan pa gjyq.

Br.IS së bashku me b.p. “Antonio Gramshi” u gjendën në zonën e operacionit gjerman të koduar me emrin “Horridoh” në zonën Vlorë-Gjirokastër, që zhvillohej në kuadër të operacionit

gjerman të dimrit. Pas disa manovrave të suksesshme, forcat partizane arritën të çajnë rrethimin. Por çarja e rrethimit ishte meritë e partizanëve shqiptarë, të cilët në luftë guerile ishin të paarritshëm. Për më tepër një pjesë e tyre vepronin në krahinat ku jetonin e për këtë ata njihnin çdo shteg, do të shkruante autori italian Batista Kavaloto në librin e tij “Si u bëra partizan”.

Për atmosferën shoqërore që ekzistonte mes partizanëve shqiptarë, veçanërisht me vajzat partizane, ata i kishin vënë vetes detyrë që të mbanin lart moralin partizan me buzëqeshjet e tyre, mirësjelljen, këngët, etj. Autori tregon se duke ndenjur shpeshherë me partizanët shqiptarë edhe në b.p. “Antonio Gramshi” u zhvillua një atmosferë shoqërore që në kohë të tjera nuk kishte ekzistuar kurrë. “Ne u detyruam që të linim mënjane egoizmin tonë personal dhe të ndanim me shokët çdo gjë. Mes nesh sundonte parimi “Të gjithë për një dhe një për të gjithë”.



Ra dëshmor komandanti trim, Terzilio Cardinali
Gjatë një sulmi kundër forcave balliste, më datë 7 korrik 1944, ra në luftime komandanti i batalionit Terzilio Cardinali. Kardinali ishte vënë në krye të kompanive së parë dhe të dytë të batalionit dhe në përpjekje për t’iu marrë krahun forcave balliste mori një plumb në ballë. Duke luftuar në Çerenec, afër Dibrës, për pushtimin e një kuote, ra në krye të batalionit komandanti trim, Terzilio Cardinali. Prej 10 tetorit 1943, gjer më 20 nëntor 1944, nga b.p. “Antonio Gramshi” kanë rënë dëshmorë të Shqipërisë 15 partizanë dhe 24 të tjerë u plagosën. Në ditarin e një partizani italian efektiv i b.p. “Antonio Gramshi”, përshkruhet momenti i rënies heroike të komandantit Cardinali. Br.IS e DIS gjendet në Gollobordë të Dibrës. Forca të armikut të vendosura në Cerencin e Sipërm godasin në befasi blp të Br.IS, që ndodhej në rrugë. Aty afër ishte edhe b.p. “Antonio Gramshi”. Ky u hodh në sulm me dy kompani, me komandantin Cardinali në krye, kundër 860 xhandarëve dhe ballistëve, të udhëhequr nga gjermanët. E pashë Kardinalin para se të nisej në mësymje. Ishte tërë gëzim. I shkëlqenin sytë dhe ishte i kënaqur për misionin që i ish ngarkuar në një sektor të rëndësishëm.

“Do t’i zhdukim me mësymjen tonë, - më tha. Kompania e parë u hodh tri herë në mësymje dhe pengoi tri herë kundërmësymjet e armikut. Në krye të kompanisë, që mësynte vetëm, turrej Cardinali, duke u bërë shembull për partizanët. Luftimet zhvillohen të repta, por Kardinali nuk tërhiqet. Duke qenë ai vetë në krye, vazhdojnë të goditin armikun në këtë sektor të rrezikshëm.

- Në sulm, shokë, - dëgjohet. Është zëri i Cardinalit që, pas pak minutave, ishte gati i vdekur. Tre partizanë e ngrenë dhe e heqin prej atij vendi. - Vazhdoni mësymjen, shokë... unë po vdes... Jam i lumtur... Vdes për idealin... Cardinali me luftën e tij në brigadë... vdiq si një hero, larg atdheut të tij, duke u treguar shokëve partizanë të batalionit të tij rrugën e lavdisë”. Në këtë betejë, bashkë me komandantin Cardinali ranë dhe partizanët italianë Renato Donini, Roccio Consiglio dhe Xhuzepe Rici (Antonio) të batalionit “Antonio Gramshi”, si dhe partizanët shqiptarë Hasan N. Kasmir nga Bratila dhe Islam M. Dushku nga Çorrushi i Mallakastrës. Ballistët u shpartalluan. Beteja u fitua por me çmim të lartë. Dëshmori Terzilio Cardinali u dekorua pas vdekjes me medaljen “Ylli partizan” e Klasit të Parë”. Në ditën e rënies së tij komandanti Cardinali mbushi 31 vjeç.

Dëshmorë italianë të rënë në luftime me njësitë partizane
Partizanët italianë ishin shpërndarë sipas dëshirës së tyre edhe në Br.S. Në betejën e Tendës së Qypit të zhvilluar, më 20 janar 1944, ranë dëshmorë italianët Franco Tenda, Mario Cronica dhe Xhiuseppe Richi. Në luftimet e zhvilluara më pas, më 25 janar 1944 dhe ra dhe Osvaldo Chiani Kajcë. Ndërsa në mars 1944 ra Eugenio Toriceli në Martanesh. Ndërsa në Belsh, më 20 maj 1944, ra për liri edhe Staroci Aurelio. Gjatë muajve korrik dhe gusht 1944 kanë rënë në luftime me pushtuesit nazistë në zonën e Dibrës partizanët italianë Antonio Entolo, në Fushallaj, Alfred Sebastiano në Peshkopi, Mario Polisi, në Dibër, Giovanni Tacini po në Dibër dhe Giuro Micheli. Më 14 tetor 1944, në luftimet e zhvilluara në kalanë e Prezës ra komandant toge Salvatore Umberto dhe në luftimet për çlirimin e kryeqytetit Tiranë ranë Ernesto Tagistino. Janë shpallur dëshmorë të Shqipërisë 114 ushtarakë italianë që me vullnetin e tyre u rreshtuan në formacionet partizane shqiptare, por dhe në njësitë e tyre luftarake si b.p. “Antonio Gramshi”, “Matteoti” dhe në formacionet e pushtetit të prapavijave shqiptare.

Luftëtarë të huaj që luftuan për Shqipërinë, Dëshmorë të Atdheut
Në radhët e UNÇSH-sët kanë luftuar dhe luftëtarë të tjerë të huaj, të cilët erdhën me pushtuesi, por u kthyen kundra tij. Një nderim i veçantë dhe përkujtimor shkon dhe për ish-ushtarakët britanikë, amerikanë, izraelitë, armenë, etj., që merituan mirënjohje dhe vlerësim nga Shqipëria dhe shqiptarët. Për luftëtarë armenë që janë shpallur dëshmorë të Atdheut, janë Undenberg Mosareli, rënë në Tiranë, në nëntor 1944, në kompaninë armërie në Br.IS, për partizanët armenë që luftuan në radhët e Br.IVS, rënë dëshmorë në Shqipëri janë Profik Imesopi, Mesogi Mestoria, Serjan Kociviani, Michele Armeni, Degran Akopian dhe Harami Zvuami. Për 10 ushtarakët amerikanë që ranë dëshmorë në Shqipëri për kauzën e madhe antifashiste gjatë luftës, kur një avion ushtarak amerikan u rrëzua në malet e Sheperit të Zagorisë. Për 46 ushtarakë britanikë, që ranë në vende të ndryshme të Shqipërisë për kauzën antifashiste dhe për lirinë e popujve. Për bij të kombit izraelit që u bashkuan me strukturat e forcave antifashiste shqiptare dhe 9 hebrenj ranë dëshmorë në Shqipëri. Titulli “Dëshmor i Atdheut” për luftëtarët e huaj që luftuan bashkë me partizanët shqiptarë është vlerësim, nderim, detyrim dhe respekt për vlerat e antifashizmit botëror.

ELIDIANA CANAJ
Docente Dr. në Sociologji

Batalioni “Antonio Gramshi” përkujtohet në 81-vjetorin e krijimit

Në ditën e 81-vjetorit të krijimit të Batalionit partizan me ushtarë italianë “Antonio Gramshi”, në kuadrin e 80-vjetorit të çlirimit të Atdheut dhe të 80-vjetorit të rënies heroike të komandantit të batalionit Terzilio Cardinali dhe dëshmorëve të tjerë italianë e shqiptarë në luftimet e Çerenecit, Komiteti i Veteranëve dhe Pasardhësve të LANÇ në Bashkinë Bulqizë dhe Bashkia Bulqizë në bashkëpunim me historianët Teki Kurti, Sali Onuzi, Bernard Zotaj, Sefer Duka dhe pasardhës veteranësh edhe nga Tirana, Dibra, Burreli organizuan një Konferencë Përkujtimore në Bulqizë.

Konferencës i paraprinë homazhet dhe vendosja e kurorave tek lapidari i ngritur në Çerenec, në vendin e betejës së përgjakshme të 8 korrikut 1944, ku ranë heroikisht dëshmoret italianë e shqiptarë. Lapidari i kushtohet batalionit “Antonio Gramshi” dhe dëshmorëve italianë e shqiptarë të brigadës së parë “Hero i Popullit”: Terzilio Cardinali, Rocco Consiglio, Renato Donnino, Giuseppe... , Antonio... (këtyre dy partizaneve nuk u dihet mbiemri) dhe 2 dëshmorëve shqiptarë Islam Musaj (Dushku) dhe Hasan Kasmi.

Merrnin pjesë dhe përshëndetën prefekti i Qarkut të Dibrës z. Nexhmedin Shehu, kryetarja e Bashkisë së Bulqizës znj. Festime Mjeshtri. Merrnin pjesë pasardhës të veteranëve të LANÇ nga Bulqiza, nxënës të shkollave si edhe familjarë të partizanëve italianë. Respekt të veçantë pati për fjalën e hapjes nga Xhevat Jella, kryetar i Komitetit të Veteranëve - Bulqizë. U ndoqën me shumë interes trajtimet historike shkencore, bazuar në fakte e dokumente referuar nga të ftuarit. Kështu prof. as. Dr. Teki Kurti, drejtor i Arkivit Qendror të FA-së trajtoi temën: “81 vjet nga krijimi i Batalionit partizan “Antonio Gramshi” (vështrim i shkurtër historik), Historiani ushtarak kolonel Sali Onuzi foli për “Pjesëmarrjen dhe kontributin e ish-ushtarakëve antifashistë italianë në formacionet e tjera të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare”. Prof. as. Dr. Bernard Zotaj shtjelloi temën “Partizanët antifashistë italianë që ranë dëshmorë në Shqipëri”, ndërsa historiani kolonel Sefer Duka - kryetar i Komitetit të Veteranëve dhe Pasardhësve Burrel foli për dëshmorët italianë që dhanë jetën në luftimet për çlirimin e Burrelit”.

U dëgjua për herë të parë himni i Batalionit “Antonio Gramshi” (regjistruar me kor dhe orkestër). Ky himn është kompozuar nga Artisti i Popullit Shqiptar Tish Daija, që nga fundi i vitit 1943, kur ishte vetëm 15 vjeç. Mundëm të dëgjonim himnin falë kujdesit dhe bashkëpunimit të miqve Roland Alikaj dhe Piero Beldi. U shfaq për herë të parë filmi dokumentar “Gaveta” me regjisor Kreshnik Hashorva, kushtuar humanizmit e solidaritetit të familjeve shqiptare për strehimin dhe përkujdesjen e ushtarëve antifashistë italianë pas kapitullimit pa kushte të Italisë fashiste. Ishte interesant gjithashtu tregimi i Francesco Fiore ardhur posaçërisht nga Italia bashkë me vëllain e vet Ferdinand.

Konferenca dëshmoi suksesin e bashkëpunimit! Ajo përcolli mesazhe të rëndësishme atdhetarizmi!

Risi në këtë veprimtari përkujtimore ishte edhe mesazhi i urimit që dërgoi Komiteti Kombëtar i ANPI-t dhe Sekretariati Kombëtar i ANPIT. E kaluara heroike atdhetare e popullit tonë na bën krenarë!



Këtu po postoj mesazhin:

**SHOQATA KOMBËTARE E PARTIZANËVE TË ITALISË
KOMITETI KOMBËTAR**

Prot. 154

Roma, 7 tetor 2024

Drejtuar:

Komitetit të Veteranëve dhe Pasardhësve të LANÇ – Bulqizë
Bashkisë Bulqizë

Të dashur miq dhe shokë,

Për shkak të angazhimeve të shumta dhe të ndërlikuara në lidhje me situatën e vështirë në Itali, nuk mund të marrim pjesë personalisht në konferencën tuaj. Sidoqoftë, ju po përkujtoni ngjarje të rëndësishme historike të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe, sidomos, çlirimin e Shqipërisë nga pushtimi nazifashist, një ngjarje kjo që është me rëndësi të madhe historike për ju, por edhe për ne dhe organizatën tonë të Partizanëve italianë.

Ju dhe ne vlerësojmë kontributin e ushtarëve italianë, të cilët, pas datës 8 shtator 1943, morën pjesë në luftën çlirimtare të vendeve të pushtuara nga ushtria fashiste, duke na nderuar të gjithëve në mënyrë të veçantë. Ky ishte një akt që na lejoi të rikuperonim dinjitetin tonë, që aventurizmi ushtarak fashist kishte plagosur, nëpërkëmbur dhe shkatërruar.

Në rastin e Shqipërisë, lidhja ka një rëndësi edhe më të madhe. Italia kishte pushtuar vendin tuaj më 7 prill 1939, përpara fillimit të Luftës së Dytë Botërore, duke ndjekur aspiratat e hershme, që datojnë, të paktën që nga fillimi i shekullit XX, për një ëndërr hegjemoniste dhe kolonialiste në Mesdhe dhe Ballkan. Përgjegjësia e Italisë është e dyfishtë edhe për shkak të ndërhyrjes brutale në punët e brendshme të vendit tuaj. Por lidhjet mes dy popujve e vendeve tona bëhen edhe më serioze, jo vetëm për shkak të lidhjeve të ngushta historike, por edhe sepse janë thelluar akoma më shumë përmes emigracionit

shqiptar në Itali.

Italia kishte synuar një rol kolonial, që më pas u përforcua nga fashizmi. Por pas shpërbërjes së ushtrisë fashiste, ishin ushtarët italianë ata që luftuan dhe vuajtën krah për krah me popujt e shtypur. Me këtë qëndrim, ata arritën të ndalonin turpërimin që fashizmi kishte sjellë.

Historia e Batalionit “Gramshi” shkruhet në këtë kontekst. Ishte një grup divizionesh italiane që u bashkuan në fillim me rezistencën kundër pushtimit gjerman dhe më pas në Ushtrinë Nacionalçlirimtare Shqiptare. Emri i batalionit iu dedikua Antonio Gramshit, me prejardhje shqiptare dhe themelues e udhëheqës i Partisë Komuniste italiane. Gramshi ishte një figurë e jashtëzakonshme dhe një viktimit e regjimit të Musolinit.

Heroizmi i anëtarëve të batalionit dhe dhimbja për të rënë, përfshirë figurën e Terzilio Cardinali, një personalitet i rallë nismëtar dhe komandant i batalionit i cili u nderua me medaljen e artë për trimëri ushtarak, janë dëshmi që na emocionojnë dhe na bëjnë krenarë!

Sot, me emocion, përulemi përpara monumentit të Beratit dhe këtu tek lapidari në Çerenec, ku ju nderoni kontributin e antifashistëve italianë për çlirimin e Shqipërisë. Me krenari kujtojmë pjesëmarrjen e ushtarëve italianë në paradën e organizuar për çlirimin e Tiranës dhe kthimin e tyre në Itali me armët dhe uniformat e tyre të çlirimtarëve. Gjithashtu, ne nuk harrojmë fjalët e komandantit të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare: “Ju treguat se një gjë ishte fashizmi, dhe një gjë tjetër ishte populli italian. Ne u jemi mirënjohës.

Ne do të kujdesemi për varrezat tuaja të luftës, përfshirë ato që gjenden të shpërndara në malet tona, ku zhvilloheshin betejat.” Për fat të keq, pritja e antifashistëve në Itali nuk ishte as e lumtur dhe as e lehtë. Madje mund të themi se u ndje poshtërimi i tyre, duke i çuar nëpër kampet e burgjet angleze, ku shpesh nuk ishin të ndarë nga bashkëpunëtorët e gjermanëve.

Ka histori personale dhe kolektive që dëshmojnë për demokracinë tonë, por sot përballemi me shqetësime të mëdha për shkak të problemeve sociale dhe konfliktet e vazhdueshme që na shqetësojnë të gjithëve.

Momenti që po përjetojmë është shumë i vështirë dhe perspektiva duket e errët. Por ne duhet dhe mund të gjejmë forcën për të reaguar, duke u mbështetur tek përvoja dhe rrënjët tona të përbashkëta të luftës për çlirimin nga pushtimi nazifashist. Nuk ka asnjë zgjidhje kombëtare që mund të arrihet në dëm të interesave të kombeve të tjera! Ndjenja e përkatesisë dhe krenaria Kombëtare duhet të ndërtohet sot mbi bazën e bashkimit dhe bashkëpunimit, duke ndjekur rrugën e Bashkimit Evropian dhe fillimin e një procesi të sigurisë kolektive kontinentale.

Asnjë nga problemet aktuale që kanë shpërthyer në mënyrë dramatike sot – në Lindjen e Mesme, në Evropën Lindore, në Mesdhe apo në Ukrainë – nuk mund të zgjidhen me forcë, me kërcënime bërthamore apo me përplasje ndërmjet nacionalizmave kundërshtarë.

Të gjithë pyesim me zë të lartë: A duhet të vendoset armëpushimi në Palestinë, në Liban, në Ukrainë dhe në Detin e Kuq për të zbutur krizën humanitare që po ndodh?

Le të bëjmë presion mbi qeveritë tona për të marrë iniciativë paqësore dhe të përpiqemi të rifillojmë një detantë, pa të cilën nuk mund të planifikojmë dhe të realizojmë të ardhmen që popujt tanë kërkojnë dhe e meritojnë.

Kjo është përshëndetja që ju sjellim, dhe dëshira e urimi ynë për të realizuar së bashku me ju dhe të gjithë antifashistët e Europës një të ardhme më të mirë!





KAPITEN (P) VERI TALUSHLLARI

“SHTËPIA E SHQIPTARIT” NË FILADELFIA, NDIHET FUQISHËM DORA E USHTARAKËVE

E diel, 13 tetor. Një ditë pranvere në zemër të vjeshtës këtu në Filadelfia. Pranverë edhe në zemrat e qindra shqiptarëve të mbledhur në një ditë-gur themeli për komunitetin shqiptar, jo vetëm të Filadelfias, por të gjithë Amerikës: Shoqata Atdhetare Mbarëkombëtare “Bijtë e Shqipes” pret shiritin dhe hap dyert e një ndërtese madhështore për veprimtaritë e komunitetit dhe Shkollën Shqipe “Gjuha Jonë”. Kanë ardhur të festojnë bashkë me bashkë-atdhetarët tanë këtu, shqiptarë nga Nju Jorku e Nju Xhersi, nga Bostoni e Florida, nga Tirana, Greqia, Italia, Turqia, Kanadaja... Ende pa u afruar të porta e ndërtesës në 3322 Willits Street, një pjesë e së cilës së shpejti do të marrë emrin “Ruga SKËNDERBEJ”, ajri është i mbushur me tingujt e bukur të këngëve e valleve tona popullore. Dhe ja ku shfaqet madhështore, vërtet e bukur dhe madhështore, si një hyrje kështjelle, Shtëpia e re e Shqiptarit!

Them e re, por të re atë e bënë shqiptarët e Filadelfias, pasi morën nga Bashkia e qytetit vërtet një ndërtesë historike, por gjë më të shkatërruar e të rrënuar nuk mund të gjeje!

Artur Vreko, kolegu ynë pendë-artë, me banim në rrethinat e Bostonit, e që bashkë me ushtarakun tjetër (të liruar) Subi Çako kanë udhëtuar mbi 6 orë për të ardhur në këtë festë madhështore.

Thomas Holmes ishte topograf i themeluesit të Provincës (më vonë Shtetit) të Pennsilvanisë, William Penn, dhe për meritat për projektimin e qytetit të Filadelfias iu dha një sipërfaqe toke, një pjesë të së cilës, Helena, e bija, e la në testament që të ngrihej një shkollë. Më 1803 në ndërtesën prej druri u vendos Low Dublin Academy, dhe pas nismës së një grupi veteranësh të Luftës për Pavarsi, që organizuan një lotari për mbledhje fondesh, ndërtesa u bë me mure guri të murrmë, me fasadën madhështore.



Në vitin 2006 një zjarr shkatërroi çatinë, por muret qëndruan. Më 2016 ndërtesa u emërtua vend i trashëgimisë historike dhe më 2018, Shoqata “Bijtë e Shqipes” e bleu me kusht që të përdorej si qendër komunitare dhe shkollë, saktësisht ç’ ka ajo kishte nevojë.

Dhe sot, pas një pune të jashtëzakonshme, përkushtimi, donacionesh bëhet fjalë për disa qindra-mijë dollarë, punë vullnetare, ndihme reale të biznesmenëve shqiptarë, Bordi Drejtues dhe Kryetari Dritan Matraku dalin ballëhapur para komunitetit shqiptar për këtë arritje. Nuk mund të mos ishin të pranishëm e të përshëndesnin përfaqësues të Senatorit të SHBA-së Bob Kejsi, shtetit të Pesnnsilvanisë dhe qytetit të Filadelfias.

E patjetër, Ambasadori i RSH në Washington D.C., Ervin Bushati.

Por unë këtë kronikë ua kushtoj ushtarakëve në pension e të liruar, banorë të Filadelfias.

Në kuadër të Shoqatës “Bijtë e Shqipes”, ata kanë një organizim të vetin, të quajtur “Forumi i Ushtarakëve”. Një grup shumë aktiv, e nuk e teproj të them që është një nga shtyllat më të forta të Shoqatës. S’ka si ndodh ndryshe, kur aty gjen Lutfi



Bramin e Eqerem Muratin, Hys Hasën e Bujar Gjokën, Bujar Veliajn, Haki Çollakun, Rifat Sulën, Idajet Agon, Bashkim Bërdufin, Sami Zaimin dhe Kryetarin e Forumit Ali Sopi.



Por do të veçoja kontributin e Albert Sulës, i cili me kompaninë e tij, kreu një volum të madh punimesh elektrike. Kuptohet, pa asnjë pagesë.

Po ushtaraku Eduard Zeneli? Një intelektual i vërtetë, por edhe një njeri i sakrificës e me zemër të madhe. Veç të tjerash, ai bëri të mundur sjelljen nga Shqipëria të Grupit lab e famëm madh “Çipini”, me të mrekullueshmen Katina Beleri, që aq bukur këndoi “Bijtë e Shqipes në mërgim, Shqiponja në fluturim”, me Tomorr Lelon dhe bashkëshorten e tij, Evgjeni Kiçajn, të dy ushtarakë (të liruar), që me këngën “Njësh do bëhet Kombi



ynë!” sollën epikën dhe heroiken e historisë sonë, me Tartarin, Shyqyriun, Bexhetin, Arturin, Artinolin dhe Mikelin që na dhuruan një buqetë të bukur këngësh labe e i dhanë një aromë e bukuri të veçantë, jo vetëm skenës, por gjithë festës.

Petrit Zanaj. Të shkruash për “Bijtë e Shqipes” dhe ushtarakët shqiptarë në Filadelfia e të mos përmendësh e veçosh Petritin, është e pamundur. Kam shkruar në këtë gazetë për atë episodin kur Petriti, një bir partizani u bë mik për kokë me familjen e një kundërshtari të babait të vet në LNÇ, Beniamin Risilinë, (prindërit tanë i vuri jeta dhe lufta përballë njëri-tjetrit, por jo që këtë luftë ta vazhdonim edhe ne, bijtë e tyre - thotë Petriti, - e aq më tepër këtu në mërgim), i cili me një dhuratë dhjetëra-mijë dollarë i dha frymë e jetë Shoqatës dhe Shkollës “Gjuha Jonë”.

Me dorë të hekurt Petriti menaxhon financat e Shoqatës, e këtu është një nga kyçet e suksesit të saj. Dhe nuk po flas për ato qindra orë e fundjava, kur ai bashkë me ata që përmenda dhe pjesëtarë të tjerë të Shoqatës, Vlashi, Mexhiti, Rudina, Bujari, Tajari... e pamundur t’i përmendësh të gjithë, punuan për ta kthyer në një mrekulli këtë ndërtesë, ku kishin mbetur vetëm muret.



Dhe për ta bërë mrekullisht të bukur këtë festë, do të duhej një ish skënderbegas, i ardhur qëllimisht nga Shqipëria, i mirënjohuri Dëfrim Methasani, i cili për më se dy orë moderoi e drejtoi gjithë veprimtarinë, me një entuziazëm e gjallëri që e bëri edhe më të bukur atë.

Sot në Filadelfia mërgata shqiptare shkroi një faqe të bukur të historisë së saj, e jam i sigurt që edhe Konica me atë sqimën e vet, e patjetër Noli, do të gjenin fjalë urimi e përgëzimi krejt të veçanta!

E sigurisht do të ishin krenarë!

Smog dhe blozë

Çfarë është ndotja e ajrit?

Ndotja e ajrit i referohet lëshimit të ndotësve në ajër, ndotës që janë të dëmshëm për shëndetin e njeriut dhe planetin në tërësi. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), çdo vit, ndotja e ajrit të brendshëm dhe të jashtëm është përgjegjëse për afro shtatë milionë vdekje në mbarë globin. Nëntëdhjetë e nëntë për qind e qenieve njerëzore aktualisht thithin ajër që tejkalon kufijtë udhëzues të OBSH-së për ndotësit, me ata që jetojnë në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme që vuajnë më shumë. Në Shtetet e Bashkuara, Akti i ajrit të pastër, i krijuar në vitin 1970, autorizon Agjencinë e Mbrojtjes së Mjedisit të SHBA (EPA) të mbrojë shëndetin publik, duke rregulluar emetimet e këtyre ndotësve të dëmshëm të ajrit.

Çfarë e shkakton ndotjen e ajrit?

“Shumica e ndotjes së ajrit vjen nga përdorimi dhe prodhimi i energjisë”, - thotë John Walke, drejtor i ekipit të ajrit të pastër në NRDC. Drejtimi i një makine me benzinë, ngrohja e një shtëpie me naftë, drejtimi i një termocentrali me gaz të copëtuar: Në secilin rast, një lëndë djegëse fosile digjet dhe kimikatet e dëmshme dhe gazrat lëshohen në ajër.

“Ne kemi bërë përparim gjatë 50 viteve të fundit në përmirësimin e cilësisë së ajrit në Shtetet e Bashkuara, falë Aktit të Ajrit të Pastër. Por ndryshimet klimatike do ta bëjnë më të vështirë në të ardhmen përmbushjen e standardeve të ndotjes, të cilat janë krijuar për të mbrojtur shëndetin”, - thotë Walke.

Efektet e ndotjes së ajrit

Ndotja e ajrit është tani faktori i katërt më i madh i rrezikut në botë për vdekjen e hershme. Sipas raportit të Gjendjes Globale të Ajrit për vitin 2020, i cili përmbledh kuptimin më të fundit shkencor të ndotjes së ajrit në mbarë botën, 4.5 milionë vdekje u lidhën me ekspozimet e ndotjes së ajrit të jashtëm në vitin 2019, dhe 2.2 milionë të tjera vdekje u shkaktuan nga ndotja e ajrit të brendshëm. Vendet më të populluara në botë, Kina dhe India, vazhdojnë të mbajnë barrën më të lartë të sëmundjeve.

“Pavarësisht përmirësimeve në uljen e normave mesatare globale të vdekshmërisë nga ndotja e ajrit, ky raport shërben gjithashtu si një kujtesë kthjelluese se kriza klimatike kërcënon të përkeqësojë ndjeshëm problemet e ndotjes së ajrit”, - shpjegon Vijay Limaye, shkencëtar i lartë në Zyrën e Shkencës të NRDC. Smogu, për shembull, intensifikohet nga nxehtësia e shtuar, duke u formuar kur moti është më i ngrohtë dhe ka më shumë rrezatim ultravjollcë. Përveç kësaj, ndryshimi i klimës rrit prodhimin e ndotësve alergjikë të ajrit, duke përfshirë mykun (në sajë të kushteve të lagështa të shkaktuara nga moti ekstrem dhe përmbytjet e shtuara) dhe polenin (për shkak të një sezoni më të gjatë të polenit). “Thatësisrat e nxitura nga ndryshimet klimatike dhe kushtet e thata po krijojnë gjithashtu terrenin për zjarre të rrezikshme”, shton Limaye. “Tymi i zjarrit mund të qëndrojë për ditë të tëra dhe të ndotë ajrin me grimca qindra milje në drejtim të erës.”

Efektet e ndotjes së ajrit në trupin e njeriut ndryshojnë, në varësi të llojit të ndotësit, gjatësisë dhe nivelit të ekspozimit dhe faktorëve të tjerë, duke përfshirë rreziqet individuale për shëndetin e një personi dhe ndikimet kumulative të ndotësve të shumtë ose faktorëve stresues.

Smog dhe blozë

Këto janë dy llojet më të përhapura të ndotjes së ajrit. Smogu (ndonjëherë i referuar si ozoni i nivelit të tokës) ndodh kur emetimet nga djegia e lëndëve djegëse fosile reagojnë me rrezet e diellit. Bloza—një lloj grimcash—përbëhet nga grimca të vogla kimikatesh, dheu, tymi, pluhuri ose alergjenesh që barten në ajër. Burimet e smogut dhe blozës janë të ngjashme. “Të dyja vijnë nga makina dhe kamionë, fabrika, termocentrale, inceneratorë, motorë, në përgjithësi çdo gjë që djeg lëndë djegëse fosile si qymyri, benzina ose gazi natyror,” thotë Walke.

Smogu mund të irritojë sytë dhe fytyrën dhe gjithashtu të dëmtojë mushkëritë, veçanërisht ato të fëmijëve, të moshuarve dhe njerëzve që punojnë ose ushtrojnë jashtë. Është edhe më keq për njerëzit që kanë astmë ose alergji; këta ndotës shpesë mund të intensifikojnë simptomat e tyre dhe të shkaktojnë sulme astme. Grimcat më të vogla të ajrit në blozë janë veçanërisht të rrezikshme sepse ato mund të depërtojnë në mushkëri dhe në qarkullimin e gjakut dhe të përkeqësojnë bronkitin, të çojnë në sulme në zemër dhe madje të përshpejtojnë vdekjen. Në vitin 2020, një raport nga T.H i Harvardit. Chan School of Public Health tregoi se shkalla e vdekshmërisë nga COVID-19 ishte më e lartë në zonat me më shumë ndotje grimcash sesa në zonat me pak më pak, duke treguar një korrelacion midis afatit të fundit të virusit dhe ekspozimit afatgjatë ndaj ndotjes së ajrit.

Këto gjetje ndriçojnë gjithashtu një çështje të rëndësishme të drejtësisë mjedisore. Për shkak se autostradat dhe objektet ndotëse kanë qenë historikisht në ose pranë lagjeve me të ardhura të ulëta dhe komuniteteve me ngjyrë, efektet negative të kësaj ndotjeje janë përjetuar në mënyrë disproporcionale nga njerëzit që jetojnë në këto komunitete.

Ndotës të rrezikshëm të ajrit

Një numër i ndotësve të ajrit paraqesin rreziqe të rënda për shëndetin dhe ndonjëherë mund të jenë fatale, madje edhe në



sasi të vogla. Pothuajse 200 prej tyre janë të rregulluara me ligj; disa nga më të zakonshmet janë merkuri, plumbi, dioksinat dhe benzeni. “Këto gjithashtu lëshohen më shpesh gjatë djegies së gazit ose qymyrit, djegies, ose - në rastin e benzenit - që gjendet në benzinë,” thotë Walke. Benzeni, i klasifikuar si kancerogjen nga EPA, mund të shkaktojë acarim të syve, lëkurës dhe mushkërive në afat të shkurtër dhe çrregullime të gjakut në afat të gjatë. Dioksinat, që gjenden më shpesh në ushqim, por edhe të pranishme në sasi të vogla në ajër, janë një tjetër kancerogjen që mund të ndikojë në mëlçi në afat të shkurtër dhe të dëmtojë sistemin imunitar, nervor dhe endokrin, si dhe funksionet riprodhuese. Merkuri sulmon sistemin nervor qendror. Në sasi të mëdha, plumbi mund të dëmtojë trurin dhe veshkat e fëmijëve, madje edhe ekspozimi minimal mund të ndikojë në IQ dhe aftësinë e fëmijëve për të mësuar.

Një kategori tjetër e përbërjeve toksike, hidrokarburet aromatike policiklike (PAHs), janë nënprodukte të shkarkimit të trafikut dhe tymit të zjarrit. Në sasi të mëdha, ato kanë qenë të lidhura me acarimin e syve dhe mushkërive, problemet me gjakun dhe mëlçinë, madje edhe me kancerin. Në një studim, fëmijët e nënave të ekspozuara ndaj PAH gjatë shtatzënisë treguan shpejtësi më të ngadalta të përpunimit të trurit dhe simptoma më të theksuara të ADHD.

Gazrat serrë

Ndërsa këta ndotës klimatikë nuk kanë ndikimet e drejtpërdrejta ose të menjëhershme në trupin e njeriut të lidhur me ndotës të tjerë të ajrit, si smogu ose kimikatet e rrezikshme, ato janë ende të dëmshme për shëndetin tonë. Duke bllokuar nxehtësinë e tokës në atmosferë, gazrat serrë çojnë në temperatura më të ngrohta, të cilat nga ana tjetër çojnë në shenjat dalluese të ndryshimit të klimës: rritje të nivelit të detit, mot më ekstrem, vdekje të lidhura me nxehtësinë dhe rritje të transmetimit të sëmundjeve infektive. Në vitin 2021, dioksidi i karbonit përbënte afërsisht 79 për qind të emetimeve totale të gazeve serrë të vendit dhe metani përbënte më shumë se 11 për qind. “Dioksidi i karbonit vjen nga djegia e lëndëve djegëse fosile, dhe metani vjen nga burime natyrore dhe industriale, duke përfshirë sasi të mëdha që çlirohen gjatë shpimit të naftës dhe gazit”, thotë Walke. “Ne lëshojmë sasi shumë më të mëdha të dioksidit të karbonit, por metani është dukshëm më i fuqishëm, kështu që është gjithashtu shumë shkatërrues.”

Një klasë tjetër e gazrave serrë, hidrofluorokarburet (HFCs), janë mijëra herë më të fuqishëm se dioksidi i karbonit në aftësinë e tyre për të kapur nxehtësinë. Në tetor 2016, më shumë se 140 vende nënshkruan Marrëveshjen e Kigalit për të reduktuar përdorimin e këtyre kimikateve - të cilat gjenden në kondicionerët dhe frigoriferët - dhe për të zhvilluar alternativa më të gjelbra me kalimin e kohës. (Shtetet e Bashkuara nënshkruan zyrtarisht Marrëveshjen e Kigalit në 2022.)

Poleni dhe myku

Myku dhe alergjenët nga pemët, barërat e këqija dhe bari barten gjithashtu në ajër, përkeqësohen nga ndryshimet klimatike dhe mund të jenë të rrezikshme për shëndetin. Megjithëse nuk janë të rregulluara, ato mund të konsiderohen si një formë e ndotjes së ajrit. “Kur shtëpitë, shkollat ose bizneset dëmtohen nga uji, myku mund të rritet dhe të prodhojë ndotës alergjikë të ajrit,” thotë Kim Knowlton, profesor i shkencave të shëndetit mjedisor në Universitetin e Kolumbisë dhe një ish-shkencëtar i NRDC. “Ekspozimi i mykut mund të përshpejtojë sulmet e astmës ose një përgjigje alergjike, dhe disa myk madje mund të prodhojnë toksina që do të ishin të rrezikshme për këdo që t’i thithte.”

Alergjitë ndaj polenit po përkeqësohen për shkak të ndryshimeve klimatike. “Studimet laboratorike dhe në terren po

tregojnë se bimët që prodhojnë polen - veçanërisht ragwei - rriten më shumë dhe prodhojnë më shumë polen kur rrit sasinë e dioksidit të karbonit në të cilin ato rriten,” thotë Knowlton. “Ndryshimet klimatike zgjasin gjithashtu sezonin e prodhimit të polenit dhe disa studime kanë filluar të sugjerojnë se vetë poleni i ragweed mund të bëhet një alergjen më i fuqishëm.” Nëse po, më shumë njerëz do të vuajnë nga rrjedhja e hundëve, ethe, kruajtje në sy dhe simptoma të tjera. “Dhe për njerëzit me alergji dhe astmë, majat e polenit mund të përshpejtojnë sulmet e astmës, të cilat janë shumë më serioze dhe mund të jenë kërcënuese për jetën.”

Ndotja e ajrit dhe drejtësia mjedisore

Askush nuk dëshiron të jetojë pranë një inceneratori, rafinerie nafte, porti, deponie mbetjesh toksike ose zona të tjera ndotëse. Megjithatë, miliona njerëz në mbarë botën e bëjnë këtë, dhe kjo i vendos ata në një rrezik shumë më të lartë për sëmundje të frymëmarrjes, sëmundje kardiovaskulare, dëmtime neurologjike, kancer dhe vdekje. Në Shtetet e Bashkuara, njerëzit me ngjyrë kanë 1.5 herë më shumë gjasa se të bardhët të jetojnë në zona me cilësi të dobët të ajrit, sipas ALA.

Historikisht, politikat raciste të zonimit dhe praktikat diskriminuese të huadhënies të njohura si vija e kuqe janë kombinuar për të mbajtur industritë ndotëse dhe autostradat e mbytura nga makinat larg lagjeve të të bardhëve dhe i kanë kthyer komunitetet me ngjyrë - veçanërisht komunitetet me të ardhura të ulëta dhe ato të klasës punëtore - në zona sakrifice. ku banorët detyrohen të thithin ajër të ndotur dhe të vuajnë problemet e shumta shëndetësore që lidhen me të. Përveç rritjes së rreziqeve shëndetësore që vijnë nga banimi në vende të tilla, ajri i ndotur mund të dëmtojë ekonomikisht banorët në formën e ditëve të humbura të punës dhe kostove më të larta mjekësore.

Racizmi mjedisor nuk kufizohet në qytete dhe zona industriale. Punëtorët e jashtëm, duke përfshirë rreth tre milionë emigrantë dhe punëtorë sezonalë të fermave në Shtetet e Bashkuara, janë ndër më të rrezikuarit ndaj ndotjes së ajrit – dhe janë gjithashtu ndër më pak të pajisurit, politikisht, për t’u bërë presion punëdhënësve dhe ligjvënësve për të pohuar të drejtën e tyre për të marrë frymë të pastër. ajri.

Kohët e fundit, harta kumulative e ndikimit, e cila përdor të dhëna për kushtet mjedisore dhe demografike, ka qenë në gjendje të tregojë se si disa komunitete janë të mbingarkuar me shtresa çështjesh, si nivelet e larta të varfërisë, papunësisë dhe ndotjes. Mjete si Metoda e Ekzaminimit të Drejtësisë Mjedisore dhe EJScreen i EPA-s ofrojnë dëshmi të asaj që shumë komunitete të drejtësisë mjedisore kanë shpjeguar për dekada: se ne kemi nevojë për reforma në përdorimin e tokës dhe shëndetin publik për të siguruar që zonat e cenueshme të mos mbingarkohen dhe që njerëzit që kanë nevojë për burime shumica i marrin ato.

Si të ndihmoni në uljen e ndotjes së ajrit

“Sa më pak benzinë djegim, aq më mirë po bëjmë për të reduktuar ndotjen e ajrit dhe efektet e dëmshme të ndryshimeve klimatike,” shpjegon Walke. “Bëni zgjedhje të mira për transportin. Kur mundeni, ngasni një biçikletë, ecni ose merrni transportin publik. Për vozitje, zgjidhni një makinë që merr kilometra më të mira për gallon gaz ose blini një makinë elektrike.” Ju gjithashtu mund të hetoni opsionet e ofruesit tuaj të energjisë—mund të jeni në gjendje të kërkonin që energjia juaj të furnizohet nga era ose dielli. Blerja e ushqimit tuaj në vend zvogëlon lëndët djegëse fosile të djegura në transportin e kamionëve ose ushqimin fluturues nga e gjithë bota. Dhe më e rëndësishmja: “Përkrahni udhëheqësit që kërkojnë ajër dhe ujë të pastër dhe hapa të përgjegjshëm për ndryshimin e klimës,” thotë Walke.

Për shumicën prej nesh, të kesh WiFi në shtëpi është po aq thelbësore sa mbajtja e dritave ndezur. Por ekspertët tani paralajmërojnë se lidhja juaj me internetin gjithashtu mund t'ju japë kriminelëve akses në informacionin tuaj më të ndjeshëm.

Hulumtimi i kryer nga “Broadband Genie” zbuloi se shumica e njerëzve nuk kanë ndërmarrë kurrë hapa të thjeshtë për të mbrojtur ruterat e tyre nga sulmet kibernetike. Duke i lënë cilësimet e privatësisë dhe fjalëkalimet si parazgjedhje dhe duke dështuar në përditësimin e përditësimeve jetike të sigurisë, njerëzit mund ta lënë rrjetin e tyre të hapur ndaj hakerëve.

Ja se si mund të kontrolloni nëse pajisja juaj është e përditësuar me veçoritë më të fundit të sigurisë dhe çfarë të bëni nëse nuk është. Ruterat janë pajisjet që na lejojnë të lidhemi me internetin më të gjerë duke vepruar si një portë, e cila kalon informacionin nga një pajisje në tjetrën. Ato veprojnë si bërthama e rrjetit WiFi të shtëpisë tuaj, por shumica prej nesh nuk i prekin dhe as nuk mendojnë për to pasi i lidhim.

“Broadband Genie” anketoj 3000 përdorues të internetit për të parë se si i përdornin ruterat e tyre. Sondazhi i tyre zbuloi se më shumë se gjysma e të anketuarve nuk kishin ndryshuar kurrë asnjë nga cilësimet e fabrikës së pajisjeve të tyre.

Oliver Devane, studiues i lartë i sigurisë në McAfee, thotë: “Shumë cilësime të paracaktuara mund të jenë të rrezikshme në duart e kriminelëve kibernetikë”. Për më tepër, sondazhi zbuloi se shumica dërrmuese e njerëzve nuk e kishin ndryshuar kurrë emrin ose fjalëkalimin e rrjetit WiFi.

Përditësimi i softuerit të ruterit tuaj me veçoritë më të fundit të sigurisë

Shumica e ruterave modernë do të përditësohen automatikisht me softuerin më të fundit, por disa modele të vjetra do të kërkojnë përditësime manuale.

Për të kontrolluar cilësimet e ruterit tuaj, kopjoni adresën IP (zakonisht 192.168.1.1) në shiritin e adresave të çdo shfletuesi.

Kur të kërkohet, futni emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin e administratorit, të cilat zakonisht mund të gjenden në vetë ruterin. Gjeneroni cilësimin e përditësimit të firmës së routerit dhe kontrolloni nëse ka ndonjë përditësim të disponueshëm. Nëse është e mundur, vendosni përditësimet që të shkarkohen automatikisht në të ardhmen.

Nga të anketuarit, 89 për qind nuk e kishin ndryshuar kurrë emrin e rrjetit, ndërsa 86 për qind nuk e kishin ndryshuar kurrë fjalëkalimin e administratorit dhe 75 për qind nuk e kishin ndryshuar kurrë fjalëkalimin e WiFi.

Në varësi të markës ose modelit, ruteri juaj mund të ketë një emër të paracaktuar që mund të njihet publikisht. Nëse rrjeti juaj WiFi ka ende emrin e tij të paracaktuar, kjo e bën të lehtë për hakerët të kërkojnë se çfarë lloj fjalëkalimi ka të ngjarë të ketë rrjeti juaj dhe të ngushtojë gamën e supozimeve të mundshme.

Z. Devane thotë: “Ashtu si ndryshimi i bravës në derën tuaj të përparme, ndryshimi i fjalëkalimit të parazgjedhur të ruterit do të sigurojë që vetëm njerëzit e autorizuar të mund të hyjnë në rrjetin tuaj të shtëpisë”.

Një tjetër çështje serioze e sigurisë e identifikuar nga raporti është se rreth nëntë nga dhjetë persona (89 për qind) nuk e kanë përditësuar kurrë ruterin e tyre.

Ofruesit e shërbimeve të internetit (ISP) lëshojnë shpesh përditësime të cilat shtojnë veçori të reja, zgjidhin problemet dhe rregullojnë dobësitë e sigurisë.

Kur këto nuk përditësohen, hakerët mund të përdorin dobësi më të vjetra dhe të njohura të sigurisë për të hakuar në rrjet.

Z. Devane thotë: “Kriminelët kibernetikë përfitojnë nga gabimet dhe dobësitë në firmware, për të fituar akses në informacionin tuaj në internet.



Çfarë duhet të ndryshoni për të mbajtur ruterin tuaj të sigurt?

Hyrja e administratorit: Ky identifikim jep akses në të gjitha cilësimet e ruterit, kështu që ju duhet të ndryshoni fjalëkalimin në diçka të sigurt për të lejuar vetëm përdoruesit e autorizuar në to.

Emri i rrjetit (SSID): Emri i rrjetit tonë WiFi është një dhurim i vdekur për hakerat në të cilin ruteri i markës dhe modelit po përdorni. Ndrysho emrin në diçka që nuk përfshin modelin e ruterit



Ruterat WiFi, në rrezik të sulmeve kibernetike

ose ofruesin e brezit të gjerë. Fjalëkalimi i Wi-Fi: Fjalëkalimi i paracaktuar mund të njihet për marka ose modele të veçanta.

Çaktivizo administrimin në distancë: Shumë ruterë ofrojnë një funksion të menaxhimit në distancë. Ky është një cilësim i avancuar që me shumë mundësi nuk do t'ju nevojitet kurrë.

Përditësoni firmuerin e ruterit (softuerin): Ky është sistemi operativ i ruterit tuaj; prodhuesit do të vendosin përditësime për sigurinë dhe efikasitetin. Shumica e ruterave modernë e bëjnë këtë automatikisht, por disa modele të vjetra mund t'ju duhet ta bëni këtë manualisht te kontrollat. “Mbajtja e firmuerit të përditësuar me arnimet më të fundit të sigurisë do të parandalojë që kjo të ndodhë”.

Për fat të mirë, shumica e ruterëve modernë do të kontrollojnë dhe instalojnë automatikisht përditësimet sa herë që janë të lidhur me internetin. Megjithatë, nëse keni një model më të vjetër, mund të varet nga ju që të siguroheni që rrjeti juaj të marrë të gjitha përditësimet e nevojshme të sigurisë. Nëse rrjeti juaj është i rrezikuar, hakerët mund të jenë në gjendje të përgjojnë informacione të tilla si detaje bankare ose informacione mjekësore që dërgohen përmes rrjetit.

Fqinjët e paskrupullt gjithashtu thjesht mund të kenë akses në një rrjet të pambrojtur për të shmangur detyrimin për të paguar për të tyren. Shumica e ISP-ve e bëjnë të lehtë për përdoruesit të shohin se cilat pajisje janë të lidhura me rrjetin e tyre, duke bërë të mundur të kuptojnë nëse ka ndonjë të lidhur që nuk duhet të jetë.

Megjithatë, sondazhi i “Broadband Genie” zbuloi se 75 për qind e njerëzve nuk kishin ndërmarrë kurrë hapat për të parë se kush ishte i lidhur me WiFi-në e tyre. Për të kontrolluar cilësimet e routerit tuaj ose për të ndryshuar fjalëkalimet tuaja, do t'ju duhet të lundroni në faqen e konfigurimit në internet të routerit tuaj WiFi. Për ta bërë këtë, hapni çdo shfletues interneti në një pajisje të lidhur me rrjetin tuaj WiFi dhe futni adresën IP të rrjetit tuaj në shiritin e adresës ose kërkimit.

Adresa IP për shumicën e ruterave është 192.168.1.1, por nëse kjo nuk funksionon, do t'ju duhet të kërkoni adresën e ruterit tuaj. Pasi të keni futur adresën IP dhe shtypni enter, kjo do t'ju sjellë në faqen e hyrjes ku do t'ju kërkohet të vendosni emrin e përdoruesit

dhe fjalëkalimin e ruterit tuaj, të cilat zakonisht mund të gjenden në ngjitësin ku shkruhet fjalëkalimi i paracaktuar.

Nga atje ju duhet të jeni në gjendje të lundroni nëpër cilësimet për të ndryshuar fjalëkalimet dhe emrin e rrjetit ose instaloni çdo përditësim të nevojshëm, thotë “Broadband Genie”.

Mund t'ju duhet të kontrolloni faqen e internetit të ISP-së tuaj për informacion më specifik se ku mund t'i gjeni këto cilësime. Nëse gjeni një pajisje të papritur në rrjetin tuaj ose besoni se keni qenë viktimë e një sulmi kibernetik, është e rëndësishme që të merrni masa për të siguruar rrjetin tuaj.

Së pari, shkëputni internetin dhe kryeni një rivendosje të plotë të ruterit në fabrikë, i cili do të heqë çdo kod që hakeri mund të ketë instaluar për t'i dhënë vetes akses. Pasi të jetë rivendosur



ruteri, do t'ju duhet të ndryshoni fjalëkalimin tuaj të administratorit, fjalëkalimin WiFi dhe emrat e rrjetit në diçka unike - kujdesuni të mos përsërisni asnjë nga fjalëkalimet tuaja ekzistuese ose të mos përdorni informacione personale. Së fundi, kontrolloni çdo pajisje ose llogari që mendoni se mund të jetë aksesuar për aktivitete të dyshimta dhe raportoni nëse është e nevojshme.



Qendra e Personel Rekrutimit ka filluar regjistrimin e kandidatëve për ushtarë/detarë aktiv dhe kërkon të rekrutojë 270 kandidatë, (240 meshkuj dhe 30 femra), për periudhën nga data 13.01.2024 - 21.03.2025.

Afati për dorëzimin e dokumentacionit është deri më 31 dhjetor 2024.

Për më shumë informacion na kontaktoni në numrin e telefonit dhe

WhatsApp: +355683404896